



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Masteri Shkencave në:
“Shkenca Juridike me profile: a) E drejtë penale dhe Kriminologji; b) E
drejtë tregtare”
Universiteti “Barleti”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Asoc. Dr. Enkeleda OLLDASHI

Dr. Bledar MUSTAFARAJ

Qershor /2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Master i Shkencave në “Shkenca Juridike me profile: a) E drejtë penale dhe Kriminologji; b) E drejtë tregtare”

1	IAL aplikues:	Universiteti “Barleti”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Drejtësisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në: Shkenca Juridike me profile: “E Drejtë Penale dhe Kriminologji”; “E Drejtë Tregtare”; *
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASH Nr. 549 datë 11.11.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 93 datë 23.03.2022 Urdhër QSHA Nr. 94 datë 23.03.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Urdhër MAS Nr. 607 datë 22.12.2016
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 Vite/ 4 Semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	-
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	5 PAE / 6 PAK
18	Numri i studentëve:	2021-2022 -19 studentë; 2022-2023 - 17 studentë;
19	Komente / të tjera:	Procesi i vlerësimit të jashtëm vlen vetëm për 2 (dy) profile

**Emërtimi i programit të studimit ka qenë me 4 (katër) profile, por Me UMASR Nr. 354, datë 18.06.2021 është mbyllur profili “E Drejtë Publike”, Me Vendim Senati Nr. 7, datë 23.02.2022 është miratuar mbyllja e profilit “E Drejtë e Pronësisë Intelektuale.*

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Institucioni jopublik i arsimit të lartë “Universiteti Marin Barleti” është licencuar dhe ka nisur veprimtarinë e tij në vijim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 571, datë 25.9.2005.

Me UMASR Nr. 213, datë 3.7.2020 Shkolla e Lartë Universitare Jo Publike “Universiteti Marin Barleti” riorganizohet në Universiteti “Barleti” metri fakultete: të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë; Shkencave të aplikuara dhe Industrive Kreative dhe Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit.

Universiteti Barleti (i përmendur në vijim me inicialet UniBa) është akredituar institucionalisht, ku me vendimin Nr. 60, datë 16.12.2021 të Bordit të Akreditimit, është vendosur për akreditimin institucional të institucionit të arsimit të lartë, Universiteti Barleti, me kohëzgjatje 5 vite akademike, afati i vlefshmërisë deri më 15.12.2026.

Programi i studimit është hapur fillimisht sipas UMASH Nr. 549, datë 11.11.2011, si Master i Shkencave në: Shkenca Juridike me profile: a. E Drejtë Penale dhe Kriminologji; b. E Drejtë Tregtare; c. E Drejtë e Pronësisë Intelektuale; d. E Drejtë Tregtare; Ky program është akredituar me UMAS Nr. 607, datë 22.12.2016, në vijim të vendimit Nr. 204, datë 18.11.2016 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, duke u akredituar vetëm profilet: “E Drejtë Penale dhe Kriminologji”; dhe “E Drejtë Tregtare”. Me UMASR Nr. 354, datë 18.06.2021 është mbyllur profili “E Drejtë Publike”. Me Vendimin e Senatit Nr. 7, datë 23.02.2022, është miratuar mbyllja e profilit “E Drejtë e Pronësisë Intelektuale”. Për mbylljen e këtij profili, Universiteti Barleti ka aplikuar në MASR me shkresën Nr. 227 Prot., datë 25.02.2022.

Programi Master i Shkencave në “Shkenca Juridike me profile: a) E drejtë penale dhe Kriminologji; b) E drejtë tregtare”, ofrohet nga departamenti i Drejtësisë, pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë të këtij universiteti, i konceptuar si një program i ciklit të dytë të studimeve, me 120 kredite dhe kohëzgjatje 2 vite akademike.

Nga të dhënat e administruara rezultojnë se me vendimin e senatit Nr. 84, datë 7.5.2021, një kurrikulë e rishikuar është paraqitur në Ministrinë e Arsimit, duke njoftuar ndryshimin e përmbajtjes së saj në masën deri 20%, kurrikulë e cila është bërë efektive në vitin akademik 2021-2022. Programi i studimit, objekt vlerësimi, përsa i përket profilit “E drejtë penale dhe kriminologji”, synon të përgatisë specialistë me një formim të thelluar teorik në fushën e së drejtës penale dhe kriminologjisë, të aftë të zgjidhin problemet që hasen gjatë procesit të demokratizimit të shoqërisë dhe parandalimit të krimit. Nëpërmjet profilit “E drejtë tregtare”, synon të përgatisë specialistë me një formim të thelluar teorik në fushën e së drejtës tregtare dhe të aftë të gjejnë

zgjdhjet e duhura për çështje në fushën e së drejtës tregtare. Në përputhje me këtë synim, programi ka si objektiva që në këto fusha të së drejtës, të pajisë studentët me formim teorik të thelluar si dhe t'i aftësojë të zgjidhin çështjet që lidhen me to si dhe të kryejnë studime në këto fusha (*Evidenca 9, nenet 2, 3*). UniBa ka aplikuar pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për akreditimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Juridike me profile: a) E drejtë penale dhe Kriminologji; b) E drejtë tregtare”, ku me shkresën Nr. 49/3 Prot., datë 26.5.2022 të kësaj Agjencie, ka marrë konfirmimin për aplikimin e kryer për qëllim akreditimi.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (i përmendur në vijim me inicialet GVJ) është trajnuar paraprakisht nga ASCAL; ekspertët e jashtëm janë njohur me parimet kryesore të procesit të vlerësimit.

Raporti i vlerësimit të jashtëm (i përmendur në vijim me inicialet RVJ) është hartuar nga GVJ në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. RVJ bazohet në të dhënat e marra nga shqyrtimi i dokumentacionit që ka vënë në dispozicion IAL dhe vizitës së realizuar në institucion. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesin sa më drejt e në mënyrë objektive, performancën e institucionit në ofrimin e këtij programi studimi. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele (sipas sistemit të standarteve të vendosur nga ASCAL):



- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht (www.ascal.al/standardet).

Procesi është koordinuar nga ASCAL brenda afatit të caktuar, me të cilin grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij.

Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga Prof. As. Enkeleda Olldashi, eksperte dhe drejtuese e GVJ, dhe Dr. Bledar Mustafaraj, ekspert (të caktuar me urdhrin datë 17.1.2023, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë). Gjatë gjithë këtij procesi, me përjashtim të vizitës në IAL, GVJ është asistuar nga znj. Majlinda Demirneli, përfaqësuese e ASCAL.

Gjatë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar dokumentet dhe informacionet e përgatitur nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi, i cili ka shërbyer për hartimin e raportit të jashtëm. Dokumentacioni ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetjeve, të cilat u realizuan gjatë vizitës në institucion. Gjithashtu, informacion i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë vizitës në departamentin e Drejtësisë në UB, të zhvilluar në datat 27-28 Shkurt 2023 sipas një agjende gjithëpërfshirëse.

Grupi i vlerësimit të jashtëm, në këtë raport është përpjekur të pasqyrojë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. GVJ jep vlerësim pozitiv të



arritjeve të bëra nga UniBa në ofrimin e një programi të mirë Master i Shkencave në “Shkenca Juridike me profile: a) E drejtë penale dhe Kriminologji; b) E drejtë tregtare”; gjithashtu jep disa sugjerime/rekomandime, të cilat vlerësohet se do të ndihmojnë stafin akademik, kërkimor dhe administrativ për të arritur objektivat e tyre, të krahasueshëm me nivelet ndërkombëtare për gjeneratën e ardhshme të juristëve.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 204, datë 18.11.2016, janë si më poshtë vijon:

1. Përmirësimin në vijim të literaturës në funksion të këtij programi studimi;
2. Ndërmarrjen e procesve të cilësisë që lidhen me vlerësimin dhe përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies në këtë program studimi;

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1. Lidhur me rekomandimin e parë GVJ konstaton që, institucioni ka ndërmarrë veprime konkrete me qëllim përmirësimin në vijim të literaturës që përdoret për këtë program studimi. U konstatua se biblioteka zotëron fondin e saj fizik me tekste dhe materiale në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, fond i cili pasurohet herë pas here me blerje të reja në varësi të nevojave të evidentuara nga departamenti. Pasurimi i titujve në bibliotekështë vërtetuar me dokumentet e vënë në dispozicion (*Evidenca 28. “Lista e titujve të librave që kanë lidhje me programin e studimit”*; *Evidenca 29 “Komunikime për pasurimin e bibliotekës”*).

Biblioteka ka infrastrukturë për aksesimin e titujve të librave në disa biblioteka *online* si për shembull *EconBiz*, *JSTOR*, etj., të cilat ofrojnë një larmi titujsh në fushën e studimeve në të drejtën tregtare, penale dhe të kriminologjisë (*Evidenca shitesë 27*; *Evidenca shitesë 28*). Po ashtu, institucioni ka mundësuar një platformë digjitale të menaxhimit të librit, me anë të cilit mund të bëhet kërkimi i titujve të librave fizikë që ndodhen në bibliotekë, kërkimi i librave elektronikë dhe punimet e diplomave (*Evidenca “Aneks 8. Platforma e bibliotekës online”*).

Aksesi në bibliotekën online sigurohet në bazë të abonimit, është pa pagesë për përfituesit e saj si dhe mund të arrihet nëpërmjet shërbimit *wifi* të internetit, në ambientet e UniBa. GVJ konstaton se kyrekomandim është plotësuar plotësisht.

2. Lidhur me rekomandimin e dytë GVJ konstaton se institucioni ka përmirësuar aktet e brendshme rregullatore në funksion përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Së pari, në Rregulloren e programit janë përfshirë përcaktime lidhur me vlerësimin


periodik të programit të studimit dhe subjektet që përfshihen në të (*Evidenca shitesë 9, neni 34*). Së dyti, institucioni ka miratuar Rregulloren për vlerësimin dhe administrimin e performancës, e cila parashikon procedura konkrete për vlerësimin e të gjitha kategorive të personelit, në periudha të ndryshme të vitit akademik, në përfundim të të cilave arrihet në konkluzione konkrete (*Evidenca 22*). Së treti, institucioni dëshmon përfshirjen e një sërë subjektsh në proceset e përmirësimit të programit të studimit, të cilët kanë bërë propozime konkrete, si dhe, në përputhje me procedurat e brendshme, ka realizuar ndryshime në programin e studimit kur ka rezultuar e dobishme (*Evidenca shitesë 1 "Dokumentacion me grupet e interesuara"; Evidenca 28; Evidenca "Propozim për riorganizimin e programit"*). GVJ konstaton se ky rekomandim është plotësuar plotësisht.

Universiteti "Barleti" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 11.05.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 13/52 Prot, datë 10.05.2023. Universiteti "Barleti" përcjell në ASCAL më datë 19.05.2023, me anë të shkresës me Nr. 602 Prot, datë 17.05.2023, "Kthim përgjigje tuajës Nr. 13/53 Prot, datë 11.05.2023", ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.


Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Shkenca Juridike me profile: a) E drejtë penale dhe Kriminologji; b) E drejtë tregtare"

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti "Barleti" ka një strukturë akademike që përbëhet nga katër njësi kryesore: <ol style="list-style-type: none"> 1. Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë; 2. Fakulteti i Shkencave të aplikuara dhe Industrive Kreative; 3. Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit; 4. Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë, si njësi kryesore pranë të cilit orfohet programi i studimit Master i






	<p>Shkencave në “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E Drejtë tregtare”, e ushtron aktivitetin akademik në funksion të ruajtjes së interesave dhe vlerave arsimore dhe kulturore kombëtare.</p> <p><i>(Evidenca 1 ; Evidenca 2; Evidenca 3)</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p> <p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare” ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë (si njësi bazë), i cili është një ndër njësitë bazë të Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë.</p> <p>Ky program studimi ofrohet në një nga fushat e drejtimit dhe të veprimtarisë akademike të këtij institucioni, sikundër është dhe fusha e drejtësisë.</p> <p>Universiteti “Barleti” ofron dhe programe të studimit të ciklit të dytë, sikundër është dhe programi i studimit Master i Shkencave në “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare”, mbështetur në aktet e brendshme të institucionit (statuti, rregullorja e përgjithshme dhe rregulloret përkatëse për cdo program studimi). Ky program studimi është brenda fushave të studimit dhe të drejtimit akademik të institucionit.</p> <p><i>(Evidenca 1 ; Evidenca 2; Evidenca 3; Evidenca shtesë 9)</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Ky program studimi, si një program studimi i ciklit të dytë, synon të promovojë vlerat kombëtare në fushën përkatëse të studimit. Kjo realizohet përmes përfshirjes në kurrikulën e programit të studimit të lëndëve që synojnë njohjen e akteve bazë dhe specifike në fushën e së drejtës penale dhe tregtare, jo vetëm për ushtrimin e profesionit nga ana e të diplomuarave në tregun e brendshëm kombëtarë, por akoma më gjerë, në një treg global.</p> <p><i>(Evidenca 1; Evidenca 2; Evidenca shtesë 9)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit:</i></p> <p><i>Universiteti “Barleti” ofron programe të studimit në ciklet përkatëse të studimeve, sikundër është dhe programi i studimit Master i Shkencave në “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare”, mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e arsimit të lartë, si dhe në aktet e brendshme të organizimit dhe funksionimit të institucionit, duke synuar realizimin e misionit dhe qëllimeve në fushat përkatëse të</i></p>





	<i>studimit (statuti, rregullorja e përgjithshme dhe rregullorja përkatëse për këtë program studimi).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Universiteti “Barleti” ka përvojën e duhur institucionale në fushën e arsimit të lartë, duke ofruar programe të studimit në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve në fushën e drejtësisë. Në këtë fushë specifike të studimeve, institucioni ka angazhuar një staf akademik me përvojë në lëmin e të drejtës private dhe publike/penale, të cilët kanë kualifikimin e nevojshëm akademik.</p> <p>Bazuar në informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL (<i>Tabelat përmbledhese per Aneks_RVB_MSh-Penale-Kriminologji_Tregtare.docx</i>), tabelat 1 dhe 2, rezultoi se Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë për vitin akademik 2022-2023 ka gjithsej 66 pedagogë, nga të cilët 30 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: 1 ka titullin “Prof”, 8 kanë titullin “Profesor i Asociuar”, 9 kanë gradën Dr./PhD, dhe 12 Asistent Lektorë me Msc; dhe 36 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 2 kanë titullin “Profesor”, 3 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 19 kanë gradën Dr./PhD. dhe 12 Asistent Lektorë me Msc.</p> <p>Ndërsa në departamentine Drejtësisë për vitin akademik 2022-2023, janë 22 pedagogë, nga të cilët 10 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: 4 kanë titullin “Profesor i Asociuar”, 2 kanë gradën Dr./PhD, dhe 4 Asistent Lektorë me Msc; dhe 12 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 1 ka titullin “Profesorë të Asociuar”, 6 kanë gradën Dr./PhD. dhe 5 Asistent Lektorë me Msc.</p>


<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare” ofrohet në një nga fushat e studimit akademik të njësive kryesore dhe njësive bazë (Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë& Departamenti i Drejtësisë).</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë (njësia kryesore) ofron programe studimi akademike dhe kërkimore në fushën e të drejtës, ekonomisë dhe qeverisjes. Fusha e përgjithshme e studimit dhe fushat specifike të këtij programi studimi janë në përputhje me fushën kryesore, në të cilën zhvillon aktivitetin akademik njësia bazë, pranë të cilit ofrohet dhe ky program studimi. Fusha bazë e studimit është fusha e drejtësisë dhe ajo specifike është në të drejtën penale dhe tregtare.</p> <p>Ky program studimi klasifikohet në nivelin 7 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, sipas direktivave dhe udhëzimeve përkatëse kombëtare dhe evropiane.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare” nuk është një program multidisiplinar. Ky program studimi ofrohet vetëm nga një njësi bazë (Departamenti i Drejtësisë).</p> <p><i>(Evidenca shtesë 9; Evidenca shtesë “minutat e takimit të GVJ-së në institucion”)</i></p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.</p>	<p>Kriteri nuk aplikohet në këtë program studimi <i>(sipas GVB-së fq.9)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Universiteti “Barleti”, me përvojën e duhur akademike dhe kërkimore në fushën e arsimit të lartë, ofron në vijimësi mbështetje profesionale për stafin akademik në formën e trajnimeve apo dhe të auditoreve të hapura akademike.</p> <p><i>(Evidenca shtesë 54.7; Evidenca shtesë “minutat e takimit të GVJ-së në institucion”)</i></p>




Konkluzione	<i>GVJ në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit:</i> <i>Universiteti “Barleti” ka përvojën e duhur institucionale në fushën e arsimit të lartë, për të ofruar programe të studimit në ciklin e dytë të studimeve dhe më specifikisht në fushën e drejtësisë. Programi i studimit Master i Shkencave në “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare” ofrohet brenda fushës bazë akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore dhe njësisë bazë (Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë& Departamentit të Drejtësisë).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Universiteti “Barleti” ka hartuar dhe miratuar aktet e brendshme për mbarëvajtjen dhe funksionimin e njësive akademike dhe ndihmës-akademike. Aktet e brendshme në formën e rregulloreve për çdo njësi akademike kanë të përcaktuara qartë detyrat, funksionet dhe bashkëpunimin akademik ndërmjet tyre. Rregullorja e njësive bazë, pranë të cilit ofrohet dhe programi i studimit Master i Shkencave në “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare” ka të përcaktuar detyrat e drejtuesit të njësive, të koordinatorit të programit, të stafit akademik dhe bashkëpunimit apo koordinimit ndërmjet aktorëve përkatës në procesin akademik. <i>(Evidenca 1; Evidenca 2; Evidenca shtesë 9; Evidenca 12)</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me	Në funksion të veprimtarisë akademike të institucionit, por edhe të këtij programi studimi, institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. Këto marrëveshje bashkëpunimi kanë mundësuar shkëmbimin e përvojave akademike të stafit, duke mundësuar dhe rritjen e kapaciteteve akademike. Nëpërmjet

<p>institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>programit Erasmus+ është mundësuar mobiliteti i stafit akademik dhe studentëve. Katër prej pedagogë të kësaj njësie kryesore kanë qenë pjesë e kësaj përvoje akademike dhe dy studentë, të cilët po realizojnë studimin e tyre në një semestër akademik në Universitetin e Madridit/ Spanjë (<i>sipas RVB-së fq. 10</i>).</p> <p>(Evidenca 15; Evidenca shtesë 3)</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Në funksion të programit të studimit Master i Shkencave në “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare”, në nivelin e njësisë kryesore dhe bazë, janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet publike dhe private. Këto marrëveshje janë dhe në funksion të realizimit të praktikave profesionale dhe të bashkëpunimit akademik. Marrëveshjet janë dhe në funksion të krijimit të kontakteve të institucionit me aktorët e tregut të punës për vijimin e bashkëpunimit dhe të punësimit të studentëve pas diplomimit të tyre.</p> <p>Për realizimin e praktikës profesionale dhe të mbykqyrjes/ drejtimit të saj nga stafi akademik (PAE), institucioni ka hartuar dhe akatet përkatëse për evidentimin dhe vlerësim përkatës.</p> <p>(Evidenca 6; Evidenca 14; Evidenca 15 Evidenca shtesë 4; Evidenca shtesë 4.1; Evidenca shtesë 3)</p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare”, harton raportin vjetor në fund të vitit akademik. Raporti vjetor i hartuar nga njësia bazë (Departamenti i Drejtësisë) përmban elemente të analizës së punës akademike dhe administrative të kësaj njësie, në funksion të procesit mësimor. Pjesë e kësaj analize janë dhe dobishmëritë nga marrëveshjet e bashkëpunimit, por jo si një komponentë i mëvetshëm.</p> <p>Njësia nuk harton një raport të vecantë për përfitimet apo për zgjerimin e bashkëpunimit të saj me institucionet publike/private, i cili do të mundësonte një panoramë më të qartë për hapat në vijimisi. <i>GVJ rekomandon që njësia të hartojë dhe një raport vjetor mbi evidentimin dhe përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të komponentëve të procesit mësimor.</i></p> <p>(Evidenca 15; Evidenca me numrin rendor 76)</p>





Konkluzione	<p><i>GVJ në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit:</i></p> <p><i>Në funksion të programit të studimit Master i Shkencave në “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare”, institucioni (në nivelin e njësisë kryesore dhe bazë) ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet publike dhe private në funksion të realizimit të praktikave profesionale, të krijimit të kontakteve të institucionit me aktorët e tregut të punës për vijimin e bashkëpunimit dhe të punësimit të studentëve pas diplomimit të tyre.</i></p> <p><i>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare” harton në fund të vitit akademik një raport vjetor në funksion të procesit mësimor. Njësia nuk harton një raport të vecantë për përfitimet apo për zgjerimin e bashkëpunimit të saj me institucionet publike/private. <u>GVJ rekomandon</u> që njësia bazë (Departamenti i Drejtësisë) të hartojë dhe një raport vjetor mbi evidentimin dhe përfitimin nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të komponentëve të procesit mësimor.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË


<p>Standardi II.1</p> <p>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare” është i organizuar në bazë të krediteve ECTS. Ky program studimi përbëhet nga 120 ECTS</p>





<p>vlërësuar në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>përgjatë dy viteve akademik të ndara në 60 ECTS në cdo vit akademik.</p> <p>Lëndët/modulet që janë pjesë e këtij program studimi janë të grupuara sipas kategorive karakterizuese, buzuar në ndarjet përkatëse sipas akteve nënligjore në fuqi në fushën e arsimit të lartë (A, B, C, D dhe E).</p> <p><i>(Evidenca shtesë 9; Evidencat "Syllabuset e lëndëve")</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në "E drejta penale dhe kriminologji" dhe "E drejtë tregtare" është i organizuar në dy profile:</p> <p><u>Profili "E drejtë penale dhe kriminologji"</u>, i cili synon përgatitjen e specialistëve me një formim të thelluar teorik në fushën e së drejtës penale dhe kriminologjisë, të aftë të jenë pjesë e zgjidhjeve të problematikave që shfaqen për parandalimin e fenomenit të kriminalitetit;</p> <p><u>Profili "E drejta tregtare"</u>, i cili synon përgatitjen e specialistëve me një formim të thelluar teorik në fushën e së drejtës tregtare dhe të aftë të gjejnë zgjidhjet e duhura për çështje në fushën e së drejtës tregtare. Ky program studimi ka synim të pajisë studentët me formim teorik të thelluar si dhe t'i aftësojë ata në zgjidhjen e çështjeve specifike si dhe të kryejnë studime të thelluara në fushën e të drejtës penale dhe tregtare.</p> <p><i>(Evidenca shtesë 9; Evidencat "Syllabuset e lëndëve").</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në "E drejta penale dhe kriminologji" dhe "E drejtë tregtare" është i organizuar sipas sistemit të krediteve ECTS. Pjesë e këtij program studimi janë dhe kreditet ECTS të përcaktuara për praktikën profesionale, e cila bën pjesë në kategorinë karakterizuese D. Kjo lëndë përbëhet nga 12 ECTS dhe zhvillohet përgjatë vitit të dytë akademik. Në semestrin e dytë të vitit të dytë akademik studentët përgatisin dhe detyrimin përmbyllës në formën e punimit të diplomës, e cila përbëhet nga 18 ECTS.</p> <p><i>(Evidenca shtesë 9; Evidenca shtesë 8; Evidenca shtesë 56)</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi,</p>	<p>Kriteri nuk aplikohet në këtë program studimi <i>(sipas GVB-së fq.13)</i></p>




<p>që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Kriteri nuk aplikohet në këtë program studimi (sipas GVB-së fq.13)</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike me profile: “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare” është i organizuar në aspektin strukturor dhe akademik sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e arsimit të lartë. Mënyra e pranimit të studentëve është përcaktuar në rregulloren e përgjithshme të universitetit si dhe në rregulloren e këtij program studimi. Ky program studimi është i organizuar me 120 ECTS, në dy vite akademike, në formën e studimeve me kohë të plotë që në fund të studimeve lëshohet diploma e ciklit të dytë të studimeve (sipas modelit të miratuar nga MAS). (Evidenca shtesë 9)</p>




<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë,</p>	<p>Kriteri nuk aplikohet në këtë program studimi (<i>sipas GVB-së fq.13</i>)</p>			
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike me profile: “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare” është program i ciklit të dytë të studimeve në nivelin 7 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.</p> <p>Lëndët në programin e studimit Master i Shkencave në “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare” janë të shoqëruara me kodin përkatës, sipas gërmave dhe numrave të përcaktuara/miratuara në aktet ligjore nga ministria përkatëse.</p>			
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Kriteri nuk aplikohet në këtë program studimi (<i>sipas GVB-së fq.14</i>)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit:</i></p> <p><i>Programi i studimit Master i Shkencave në “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare” është i organizuar sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e arsimit të lartë. Mënyra e strukturimit të këtij program studimi (në 120 ECTS, në katër semestra, në dy vite akademike) është përcaktuar në rregulloren e përgjithshme të universitetit si dhe në rregulloren e këtij program studimi. Ky program studimi është i organizuar në dy profile (“E drejtë penale dhe kriminologji” & “E drejta tregtare”), të cilat synojnë përgatitjen e specialistëve me formim të thelluar teorik më fushën e së drejtës penale dhe tregtare.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>




Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

Fakulteti i Ekonomisë Qeverisjes dhe Drejtësisë, si njësi kryesore pranë të cilit ofrohet programi i studimit Master i Shkencave në “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare”, përbëhet nga tre njësi bazë:

1. Departamenti i Drejtësisë;
2. Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës;
3. Departamenti i Qeverisjes, Shkenca Politike dhe Komunikim;

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

Fakulteti i Ekonomisë Qeverisjes dhe Drejtësisë, në vitin akademik aktual 2022-2023, ka 66 staf akademik gjithsej, ku 30 janë pedagogë me kohë të plotë, dhe 36 pedagogë me kohë të pjesshme.

Fakulteti i Ekonomisë Qeverisjes dhe Drejtësisë	PAE	PAK
Prof. Dr.	1	2
Prof. As. Dr.	8	3
Dr. / PhD.	9	19
MSc.	12	12
Në total	30	36
Totali	66	

Njësia bazë, Departamenti i Drejtësisë, përgjegjës për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë për vitet akademike:

Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	1	-	-

Prof. Asoc.	2	1	2	1	4	1
Dr./PhD.	2	6	4	5	2	6
Msc.	3	1	6	2	4	5
Totali	7	8	12	9	10	12

(Evidenca. Shtese Tabelat permbledhese per Aneks_RVB_MSh-Penale-Kriminologji_Tregtare.docx)

Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.

Programi i studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike me profile: “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare” ka një koordinator, detyrat e të cilit janë të përcaktuara në rregulloren e njësisë kryesore dhe njësisë bazë.

Drejtuesi i departamentit/ njësisë bazë dhe koordinatori i programit të studimit kanë detyra të mirëpërcaktuara në aktet e brendshme të institucionit.

(Evidenca shtesë 9 ; Evidenca shtesë 6)

Konkluzione

GVJ në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit:

Njësia kryesore (Fakulteti i Ekonomisë Qeverisjes dhe Drejtësisë), pranë të cilit ofrohet programi i studimit Master i Shkencave në “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare”, përbëhet nga tre njësi bazë, të cilat drejtohen nga drejtuesit përkatës. Departamenti i Drejtësisë, pranë të cilit është i organizuar dhe ofrohet dhe ky program studimit, drejtohet nga drejtuesi i departamentit dhe në funksion të këtij program është emëruar/caktuar dhe një koordinator përgjegjës, detyrat dhe funksionet e të cilit janë të përcaktuara në aktet e brendshme të institucionit. Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtuesve janë në funksion të procesit mësimor dhe të cilësisë së njësive përkatëse.


Shkalla e përmbushjes së standardit

Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Njësia kryesore (Fakulteti i Ekonomisë Qeverisjes dhe Drejtësisë), pranë të cilit ofrohet programi i ciklit të studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike me profile: “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare”, ofron informacionin e duhur mbi strukturën akademike dhe organizative të këtij programi. Ky program studimi është i organizuar në 120 ECTS, në dy vite akademike (katër semestra akademik).</p> <p><i>(Evidenca 1; Evidenca 2; Evidenca 12; Evidenca shtesë 9)</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike me profile: “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare” është strukturuar në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e arsimit të lartë. Lëndët që janë pjesë e kurrikulës së këtij programi studimi të ciklit të dytë janë të organizuara në bazë të krediteve me orë të përcaktuara në auditor (në formën e leksioneve dhe seminareve) dhe orëve të pavarura të studentit jashtë auditorit. Pjesë e kurrikulës janë dhe praktikë profesionale dhe detyrimet përmblylëse.</p> <p><i>(Evidenca shtesë 9 ; Evidenca me numrin rendor 73 “Plani mësimor”)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike me profile: “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare” është i aksesueshëm për studentët. Njësia bazë mundëson për stafin akademik rishikimin dhe përmirësimin e përmbajtjeve të programeve të lëndëve/syllabuset në për cdo vit akademik, duke mundësuar versionin elektronik dhe hard copy <i>(sipas RVB-së, fq.16)</i>.</p> <p>Në rregulloren e përgjithshme të institucionit, të njësisë kryesore dhe njësisë bazë, janë të përcaktuara rregullat dhe informacioni teknik për pranimin e studentëve, transferim të studimeve dhe njohjes së lëndëve përkatëse. Ky proces realizohet në bazë të vendimmarrjes së njësisë përkatëse <i>(Evidenca 35)</i>.</p> <p>Në këtë program studimi nuk ka studentë të transferuar/ardhur nga ndonjë institucion i arsimit të lartë brenda apo jashtë vendit <i>(Evidenca ‘Minutat e takimit të GVJ-së në institucion- në</i></p>





	<i>sekratrinë mësimore); (Evidenca 1; Evidenca 2; Evidenca shitesë 9)</i>			
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	<p>Informacioni mbi strukturën dhe përmbajtjen e këtij programi studimi është përcaktuar në rregulloren e programit. Në këtë rregullore janë përcaktuara kategoritë karakterizuese të programit të ndara sipas aty të përcaktuara në aktet nën ligjore në fushën e arsimit të lartë. Kreditet për çdo grup lëndësh karakterizuese janë njëkohësisht të përcaktuara, në bazë të nukrit të krediteve ECTS. Informacionin mbi përmbajtjen e rregullores së programit është i aksesueshëm për studentët dhe stfin akademik. Përmbajtja e lëndëve të kurrikulës së programit të studimit është pjesë e informacionit të aksesueshëm për studentët. Syllabuset e lëndëve janë të hartuara nga pedagogët përgjegjës dhe firmosur nga drejtuesi i njësisë përkatëse.</p> <p><i>(Evidencat me numrin rendor 82-100 & 108-126 ; Evidenca shitesë 9)</i></p>			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	<p>Njësia bazë përditëson në vijimësi informacionin akademik mbi këtë program studimi. Në çdo fillim të vitit akademik/semestri akademik, stafi akademik përgjegjës për hartimin e syllabus-eve të lëndëve përmirëson/rishikon përmbajtjen e programeve të lëndëve, të cilat më pas miratohen nga njësia përkatëse (sipas RVB-së, fq.17).</p> <p><i>(Evidenca shitesë 9; Evidencat me numrin rendor 108-126 “Syllabuset e lëndëve në anglisht)</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit:</i></p> <p><i>Programi i studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike me profile: “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare” është i strukturuar dhe organizuar, bazuar në akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e arsimit të lartë, si dhe në aktet e brendshme të institucionit. Programi ka një strukturë akademike të organizuar në bazë të krediteve ECTS (120), në dy vite akademik dhe katër semestra. Përmbajtja e lëndëve të kurrikulës është në funksion të formimit të thelluar profesional të studentëve në fushën e të drejtës penale dhe tregtare.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p> <p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike me profile: “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare” është organizuar në bazë të krediteve ECTS, përgjatë dy viteve akademike. Numri i krediteve ECTS varion nga 6 deri në 10 dhe për praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse janë 12 ECTS dhe 18 ECTS.</p> <p>Lëndët dhe veprimtaritë formuese janë të shpërndara në bazë të përmbajtjes karakterizuese përkatëse. Në semestrin e parë janë kryesisht lëndët e formimit të përgjithshëm dhe në semestrat në vijim ato karakterizuese të programit të studimeve, të cilat ofrojnë njohuri të thelluara në fushën e të drejtës tregtare dhe penale. Njohuritë e ofruara nga ky program studimi mundësojnë studime të mëtejshme për studentët dhe punësim në fushat përkatëse të tregut të punës.</p> <p><i>(Evidenca shtesë 9; Evidenca me numrin rendor 73; Evidenca shtesë 8)</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike me profile: “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare” është strukturuar në bazë të orëve që zhvillohen në auditor në formën e leksioneve dhe seminareve dhe orëve të punës së pavarur. Shpërndarja e ngarkesës akademike për studentët është e balancuar përgjatë të katër semestrave akademik. Përgjatë një viti akademik janë shpërndarë 60 ECTS. Në semestrin e katër realizohet praktika profesionale dhe detyrimi përmbyllës.</p> <p><i>(Evidenca shtesë 9; Evidenca shtesë 8)</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe</p>	<p>Në këtë program studimi janë të përcaktuara veprimtaritë formuese teorike dhe praktike. Këto veprimtari janë të shpërndara</p>






<p>raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>përgjatë të katër semestrave akademik. Qëllimi i përmbytjes së lëndëve është formimi teorik dhe praktik i studentëve. Njësia bazë ka rishikuar dhe përmbytjen e kurrikulës për ta lidhur atë më shumë me tregun e punës dhe ofrimin e njohurive të thelluara teorike. <i>(Evidenca shtesë 10)</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Lëndët e këtij programi studimi përmbyjnë elementet e nevojshëm akademik. Në të gjitha lëndëte programit të studimit është përfshirë literatura e detyrueshme dhe literatura e rekomanduar/këshillueshme. Literatura është një nga elementet e programit të lëndëve që rishikohet dhe pasurohet në vijimësi.</p> <p>Gjithsesi, <i>GVJ rekomandon që stafi akademik duhet të botojë tekste akademike në funksion të programit të studimit, kryesisht në profilin “E drejta penale dhe kriminologji”, pasi në këtë profil nuk ka shumë literaturë në gjuhën shqipe.</i></p> <p><i>(Evidencat me numrin rendor 82-100 & 108-126; Evidenca shtesë 5.10.1;5.10.2;5.11;5.12;5.13;5.14;5.15;5.16)</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbytja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p> <p>Kriteri 7. Përmbytja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike me profile: “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare” përmban lëndë, të cilat mundësojnë një formim të thelluar në të drejtën tregtare dhe penale, duke nxitur dhe aftësimin profesional të të diplomuarve.</p> <p>Përmes lëndëve përkatësi si p.sh, “E drejta private e krahasuar” <i>(Evidenca shtesë 5.12)</i>; “E drejta e avancuar e detyrimeve dhe kontratave <i>(Evidenca shtesë 5.3)</i> “E drejta penale e krahasuar” <i>(Evidenca shtesë 5.14)</i>; “Krimi i organizuar” <i>(Evidenca shtesë 5.14)</i>; “Krimi ekonomik” <i>(Evidenca shtesë 5.16)</i>; “E drejta e ndërmjetësimit dhe arbitrazhit” <i>(Evidenca shtesë 5.13)</i> etj, studentët përgatiten për në tregun e punës.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit:</i></p> <p><i>Programi i studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike me profile: “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare” përmban lëndë, të cilat mundësojnë një formim të thelluar në të drejtën tregtare dhe penale, duke nxitur dhe aftësimin profesional të të diplomuarve. Në këtë program studimi janë të përcaktuara veprimtaritë formuese teorike dhe</i></p>




	<p><i>praktike të shpërndara përgjatë të katër semestrave akademik. Qëllimi i përbajtjes së lëndëve është formimi teorik dhe praktik i studentëve. Njësia bazë ka rishikuar dhe përbajtjen e kurrikulës për ta lidhur atë më shumë me tregun e punës dhe ofrimin e njohurive të thelluara teorike.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon që stafi akademik duhet të nxitet më shumë nga strukturat përkatëse akademike për botimin e teksteve në funksion të programit të studimi, kryesisht në profilin “E drejta penale dhe kriminologji”, pasi në këtë profil nuk ka shumë literaturë në gjuhën shqipe.</i></p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X


Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike me profile: “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare” është rishikuar dhe përmirësuar në funksion të kërkesave të tregut të punës. Ky përmisim i kurrikulës në këtë program studimi me profilet në të drejtën tregtare dhe penale është realizuar përmes bashkëpunimit me stafin akademik dhe bashkëpunëtorëve të tregut të punës (<i>sipas RVB-së fq.20</i>).</p> <p>(<i>Evidenca “Minutat e takimit të GVJ-së me drejtuesit e institucionit”; Evidenca shitesë 1 me numrin rendor 2</i>)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht</p>	<p>Institucioni ka të përcaktuar në dokumentart bazë (<i>Evidenca 1; Evidenca 3</i>), marrëdhënien akademike me studentët, në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimeve akademike.</p>



<p>me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Njësia bazë organizon takime me studentët përgjatë viteve të tyre akademike dhe me studentët e diplomuar (<i>sipas RVB-së fq.20</i>).</p> <p>Studentët janë të përfaqësuar në organet vendimmarrëse të institucionit (<i>Evidenca 1</i>). Njësia bazë realizon pyetorët me studentët për të marrë mendimin dhe vlerësimin e tyre për komponentët e procesit mësimor dhe për shërbimet e ofruara nga institucioni.</p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Institucioni dhe njësia bazë (Departamenti i Drejtësisë) për këtë program studimi realizon takime me grupet e profesionistëve të fushave të ndryshme për të marrë mendimin dhe vlerësimin e tyre për komponentët e procesit mësimor dhe për shërbimet që mund të ofrohen nga institucioni (<i>Evidenca shitesë 1</i>).</p> <p><i>GVJ rekomandon një bashkëpunim më gjithëpërfshirës të aktorëve të tregut të punës dhe një dokumentim/evidentim të këtij procesi në funksion të qëllimeve akademike dhe të proceseve të akreditimit.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit:</i></p> <p><i>Institucioni ka të përcaktuar në dokumentat bazë realizimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit e aktorët e tregut të punës në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimeve akademike.</i></p> <p><i>Njësia bazë organizon takime me studentët përgjatë viteve të tyre akademike dhe me studentët e diplomuar. Studentët janë të përfaqësuar në organet vendimmarrëse të institucionit.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon që ky bashkëpunim të evidentohet më mirë në funksion të qëllimeve akademike si dhe të proceseve të akreditimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.





Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike me profile: “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare”, janë të përcaktuara objektivat akademik dhe shkencor, të cilat janë në përputhje me objektivat strategjik të institucionit (<i>Evidenca 3; Evidenca shtesë 9</i>).</p> <p>Ky program studimi është i orientuar drejt studimeve të thelluara në fushën e të drejtës tregtare dhe penale dhe punimet e temave të diplomës së studentëve janë të orjentuara drejt këtyre fushave studimore dhe kërkimore. Në funksion të realizimit të objektivave mbi kërkimin shkencor, institucioni/njësia bazë ka miratuar dhe një material mbi publikimin e detyrimit final/punimit të diplomës (<i>Evidenca shtesë 21</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Njësia kryesore për këtë program studimi (Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë) bashkërendon punën akademike dhe administrative nëpërmjet strukturave përkatëse (<i>Evidenca 1; Evidenca 2; Evidenca shtesë 9</i>).</p> <p>Njësia bazë, pranë të cilit ofrohet dhe ky program studimi, respekton lirinë akademike të stafit akademik efektiv, duke mundësuar vendimarrjen e tyre në lidhje me përmbajtjen e syllabuseve dhe propozimet për veprimtaritë e ndryshme akademike. Njësia bazë ju mundëson pedagogëve pjesëmarrjen në projekte kërkimore (<i>sipas RVB-së fq.21</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Programi i studimit mundëson për studentët përfshirjen në aktivitetet akademike dhe kërkimore që organizohen nga Departamenti i Drejtësisë.</p> <p>Institucioni është i nagazhuar në projekte studimore dhe kërkimore (<i>Evidenca shtesë 20</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Aktivitetet kërkimore dhe studimore që mund të mbështeten nga njësia bazë realizohen përmes financimit në nivel institucional. Administratori i institucionit ndjek zbatimin e mbështetjes financiare për të gjitha strukturat përkatëse (<i>Evidenca 1</i>).</p> <p><i>GVJ rekomandon që institucioni duhet të përcaktoj në mënyrë specifike për njësinë bazë/departamentin fondin për veprimtaritë studimore dhe kërkimore. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion GVJ-së, për këtë proces akreditimi nuk rezulton një ndarje e tillë.</i></p>






Konkluzione	<i>GVJ në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit:</i> <i>Ky program studimi është i orjentuar drejt studimeve të thelluara në fushën e të drejtës tregtare dhe penale dhe punimet e temave të diplomës së studentëve janë të orjentuar drejt këtyre fushave studimore dhe kërkimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor	Për programi i studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike me profile: “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare”, njësia bazë mbështetet për projektet kërkimore-shkencore përmes koordinatorit përkatës (KKI). Koordinatorin për kërkimin dhe Inovacion është nën drejtimin e Zv.rektorit për kërkimin e aplikuar dhe inovacionin. Kjo strukturë organizon dhe mbështet dhe këtë program studimi në aspektin kërkimor dhe projekteve. <i>(në faqen zyrtare të institucionit www.umb.edu.al/kerkimi-shkencor-ne-ub.htm)</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Departamenti i Drejtësisë, si njësia bazë për këtë program studimi, mbështet anëtarët e departamentit për pjesëmarrje në projekte kërkimore. Studentët e këtij program studimi kanë patur mundësi të limituara për të qenë pjesë e projekteve studimore të aplikuara <i>(sipas RVB-së fq.22)</i> <i>GVJ rekomandon për një angazhim më konkret të njësisë bazë për realizimin e studimeve dhe projekteve me karakter kërkimor nga stafi akademik, duke përfshirë dhe studentët.</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të	Departamenti i Drejtësisë organizon leksione të hapura, të cilat lidhen me temat që janë pjesë e këtij programi studimi. Këto orë të hapura lidhen dhe me tema të aktualitetit në fushën e drejtësisë <i>(Evidenca shtesë 19)</i> . Institucioni ka organizuar disa konferenca




<p>cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>bienale të organizuar dhe nga njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike me profile: “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare”, përmban lëndë që mundësojnë njohuri të thelluara në fushat respektive të së drejtës. Njohuritë e ofruara në këtë program studimi lidhen me tregun kombëtar dhe ndërkombëtar. Në kurrikulën e këtij program studimi bëjnë pjesë lëndë që lidhen me kërkesat aktuale të tregut të punës si p.sh, “E drejta kibernetike” (<i>Evidenca shitesë 5.18</i>); “Informatika juridike” (<i>Evidenca 5.19</i>); ‘Krimi dhe viktimat’ (<i>Evidenca shitesë 5.20</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Kriteri nuk aplikohet në këtë program studimi (sipas GVB-së fq.23)</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>Kriteri nuk aplikohet në këtë program studimi (sipas GVB-së fq.23)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit:</i> <i>Programi i studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike me profile: “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare”, përmban lëndë që mundësojnë njohuri të thelluara në fushat respektive të së drejtës. Njohuritë e ofruara në këtë program studimi lidhen me tregun kombëtar dhe ndërkombëtar.</i></p>





	<p>Në kurrikulën e këtij program studimi bëjnë pjesë lëndë që lidhen me kërkesat aktuale të tregut të punës si p.sh. “E drejta kibernetike”; “Informatika juridike; krimi dhe viktimat.</p> <p><i>GVJ rekomandon për një angazhim më konkret të Departamentit të Drejtësisë për realizimin e studimeve dhe projekteve me karakter kërkimor nga stafi akademik, duke përfshirë dhe studentët.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT


Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Programi objekt vlerësimi ofron mësimdhënie në forma të ndryshme, duke përfshirë leksione, seminare, prezantime, detyra kursi, projekte kërkimi, pjesëmarrje në veprimtari të tjera shkencore si dhe praktikë profesionale. Ndarja e orëve mësimore është balancuar drejt midis orëve për transmetim dijesh dhe orëve për lexim, hulumtim, dhe përgatitjet individuale të studentëve. Gjithashtu, stafi akademik organizon leksione të hapura si dhe veprimtari me studiues dhe profesionistë të jashtëm (Evidenca shtesë 9, nenet 11, 12; Evidenca shtesë 19; Evidenca shtesë 48; Evidenca shtesë “Minutat e takimit”).





<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Në përgjithësi, format dhe metodat e mësimdhënies janë të larmishme dhe u sigurojnë studentëve mundësitë e duhura për mësimnxënie sipas nevojave të tyre. Kjo gjë u theksua edhe nga studentët, gjatë takimit të zhvilluar me ta, të cilët vlerësuan larminë e qasjeve didaktike të pedagogëve dhe faktin që ato iu përshtaten tipologjive të ndryshme të studentëve. Kjo qasje praktike, duhet pasqyruar në mënyrë të plotë në syllabus-et e programit, të cilët jo gjithnjë sigurojnë detaje të mjaftueshme mbi përmbajtjen e temave dhe qasjen e mësimdhënies.</p> <p><i>(Evidenca shitesë "Minutat e takimit")</i>.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>UniBa ka përcaktuar një politikë mbështetëse dhe promovuese ndaj personelit të tij akademik në mënyrë që rrisin aftësitë e tyre profesionale dhe pedagogjike <i>(Evidenca 1, nenet 3/2 dhe 7/4; Evidenca 3, pika 3.2)</i>.</p> <p>IAL ka mekanizma si dhe ka vënë në jetë programe për të mbështetur kërkesat e stafit akademik për pjesëmarrje në veprimtari të përmirësimit të metodave të mësimdhënies <i>(Evidenca shitesë 13)</i>.</p> <p>Rezulton po ashtu se IAL ka lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi si dhe është mundësuar mobiliteti i personelit <i>(Evidenca 14; Evidenca 15)</i>. Rritja e mobilitetit të stafit akademik, vlerësohet se do të ndihmonte në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te studentët mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie ka përvojë në transferimin e njohurive e koncepteve të lëndëve që mbulojnë. <i>(Evidenca shitesë 14)</i>.</p> <p>Po ashtu, metodat e përdorura në mësimdhënie vlerësohen nga studentët si në pyetësorë ashtu edhe në takimin me GVJ. Kjo është një pikë e fortë e programit, e cila duhet përmirësuar më tej. Gjithashtu, GVJ vëren se përdoren metoda alternative të mësimdhënies si dhe studentët nxiten që të japin mendimin e tyre kritik për çështje të caktuara që dikutohen, raste praktike të ndryshme. Gjatë mësimdhënies përdoren metoda bashkëkohore dhe sallat janë të një niveli cilësor qoftë për zhvillimin e mësimin, diskutimeve apo për prezantimin e projekteve <i>(Evidenca shitesë "Minutat e takimit")</i>.</p>
<p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar më këtë program studimi përdor forma mësimdhënieje që inkurajojnë autonominë tek studenti.</p>




<p>respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Sipas përgjigjeve të studentëve gjatë vizitës së GVJ-së rezulton se ata kanë ndërtuar një marrëdhënie respekti të ndërsjellë me pedagogët. Studentët dhe pedagogët shkëmbejnë mendime dhe argumente lidhur me çështjet që shtrohen për zgjidhje. Marrëdhënia mes pedagogëve dhe studentëve respekton rregullat e komunikimit dhe etikës institucionale (<i>Evidenca 3, pika 3.2</i>). Institucioni ka miratuar për këtë qëllim Kodin e Etikës, i cili ndihmon garantimin e sa thënë më lart (<i>Evidenca 4</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Departamenti i Drejtësisë, brenda Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë të UniBa, është njësia bazë që ofron programin e studimit. Studentët e regjistruar në këtë program studimi kryejnë vlerësimin e formave të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Në këtë aspekt, studentët vlerësojnë pedagogët në mënyrë anonime si edhe nëpërmjet fokus-grupeve me studentë për marrjen e mendimit të tyre, ku këto vlerësime mbeten një nga elementët kryesorë për arritjen e cilësisë akademike (<i>Evidenca shpeshë 15</i>).</p> <p>Këto mënyra vlerësimi u evidentuan edhe gjatë vizitës dhe janë pasqyruar dhe pasqyrohen edhe në raportet që lidhen me vlerësimet e studentëve (<i>Evidenca "Raport i vlerësimit të studentëve"</i>; <i>Evidenca shpeshë 43</i>; <i>Evidenca shpeshë "Minutat e takimit"</i>).</p> <p>Në vijim, personeli akademik i angazhuar në këtë program, kryen vlerësimet e tij lidhur me procesin e mësimdhënies, gjë që në tërësi i vlen përmirësimin të formave dhe metodave të përdorura gjatë këtij procesi (<i>Evidenca 11</i>).</p> <p>Rezulton se njësia përgjegjëse që mbulon këtë program studimi ka ndërmarrë veprime konkrete në drejtim të përmirësimin të disa elementeve të programit, pasqyruar në analizën e përgatitur për këtë qëllim (<i>Evidenca "Propozim për riorganizimin e programit"</i>).</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me</p>	<p>Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë në UniBa ka për qëllim vlerësimin dhe kontrollin e cilësisë dhe në bazë të përcaktimeve statutores janë krijuar strukturat përgjegjëse që drejtohen në nivel institucional nga Komisioni i Sigurimit të Cilësisë. Po ashtu, në nivel institucioni është ngritur Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë (NJZHKC), si njësi e pavarur që ka për qëllim monitorimin, vlerësimin dhe</p>




<p>njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>zhvillimin e përmirësimit të cilësisë së veprimtarisë së këtij institucioni. Kjo njësi kryen vlerësimet në fjalë në mënyrë periodike (<i>Evidenca 10, nenet 3-5</i>).</p> <p>NJZHKC orienton dhe këshillon njësitë bazë për hartimin, riorganizimin dhe përmirësimin e kurrikulave si dhe formulon rekomandime dhe sugjerimeve për mënyrën e organizimit të procesit mësimor, që të ruhen dhe garantohen standardet e sigurimit të cilësisë (<i>Evidenca 10, nenet 6, 7</i>).</p> <p>IAL, nëpërmjet strukturave të tij, shfaq vullnet në drejtim të përdorimit të metodave inovative të mësimdhënies (<i>Evidenca 16; Evidenca shitesë 38</i>). Gjithashtu, konstatohet se personeli akademik ka marrë trajnim për përmirësimin dhe zbatimin e metodave të reja të mësimdhënies (<i>Evidenca shitesë 13</i>).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ për t'u shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Në këtë program studimi mësimdhënies realizohet me larmi formash, ku përfshihen leksione, seminare, prezantime, detyra kursi, projekte kërkimi, pjesëmarrje në veprimtari të tjera shkencore si dhe praktikë profesionale. Stafit akademik organizon leksione të hapura si dhe veprimtari me studiues dhe profesionistë të jashtëm. Kjo qasje praktike, duhet pasqyruar në mënyrë më të plotë në syllabus-et e programit, të cilët jo gjithnjë sigurojnë detaje të mjaftueshme mbi përmbajtjen e temave dhe qasjen e mësimdhënies.</i> - <i>IAL ka mekanizma si dhe ka vënë në jetë programe për të mbështetur kërkesat e stafit akademik për pjesëmarrje në veprimtari të përmirësimit të metodave të mësimdhënies. Gjatë mësimdhënies përdoren metoda bashkëkohore dhe sallat janë të një niveli cilësor qoftë për zhvillimin e mësimin, diskutimeve apo për prezantimin e projekteve.</i> - <i>Format dhe metodat e mësimdhënies iu nënshtrohen vlerësimit periodik si nga ana e personelit akademik, ashtu dhe nga studentët. Mbi bazën e të dhënave të marra, vijohet me reflektimin e ndryshimeve apo përmirësimeve në lidhje me këto metoda të mësimdhënies.</i> - <i>Për të garantuar përmirësimin e metodave të mësimdhënies, IAL garanton bashkëpunimin e Komisionit të Sigurimit të Cilësisë dhe NJZHKC me njësitë bazë si dhe</i>





	<i>ka organizuar trajnime për përmirësimin dhe zbatimin e metodave të reja të mësimdhënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Rregullorja e programit të studimit përcakton kriteret dhe mënyrat e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve. Kriteret dhe format e vlerësimit të studentit përcaktohen në planin mësimor dhe në syllabusin e secilës lëndë. Shkalla e përvetësimit të dijes nga studentët bëhet sipas sistemit me notë, pikë ose me përqindje dhe më shkronja (sistemi ETCS me shkronjat nga A-F). Vlerësimi me notë është i detyrueshëm. Studentët njoftohen mbi këtë rregullore gjatë javës së parë të fillimit të studimeve(orientimit), si dhe nga secili pedagog në auditor për lëndët përkatëse(<i>Evidenca shtesë 9, nenet 17-21; Evidenca shtesë "Minutat e takimit"</i>). Rregullorja dhe afatet e përcaktuara në kalendarin akademik bëhen publike dhe mund të konsultohen online (https://www.umb.edu.al/).
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Pas shqyrtimit të përmbajtjes së tyre, GVJ konstaton se syllabuset përmbajnë kriteret dhe mënyrat e vlerësimit të njohurive të studentëve. Vlerësimi bëhet përmes metodave të ndryshme dhe është i rregulluar në dokumentet dhe udhëzuesit e programit. Studentët në fillim të çdo semestri njoftohen me format dhe kriteret e vlerësimit. Gjithsesi, ka vend që <i>në syllabuse të përfshihen më shumë detaje mbi kriteret e vlerësimit të secilit komponent</i> , në veçanti matja e pjesëmarrjes dhe aktivizimit në seminare, grupet e punës, etj. (<i>Evidenca shtesë 9, neni 17, Evidencat Syllabuset e lëndëve</i>).
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e	Sipas përcaktimeve të nenit 17/2 të Rregullores së programit të studimit, lëndët e përfshira në këtë program studimi vlerësohen me metoda të vazhdueshme, dinamike e të larmishme, gjëqë

<p>shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>ofron mundësi për vlerësim të përshtatshëm të dijeve (<i>Evidenca shtesë 9</i>). Edhe pse shumica e lëndëve ndjekin vlerësimin e vazhdueshëm të ndarë në disa komponente (si p.sh. pjesëmarrja dhe aktivizimi, provimi i ndërmjetëm dhe provim përfundimtar), sugjerohet që të ketë më shumë larmi të vlerësimit, duke mos aplikuar të njëjtat forma vlerësimi për çdo lëndë. Pra, duhet bërë një vlerësim dhe ndarje duke pasur parasysh se disa lëndë mund të vlerësohen më drejt nëpërmjet eseve, kurse të tjera nëpërmjet provimeve dhe projekteve grupore, me synimin që në fund, studentët të pajisen me aftësi të ndryshme akademike e profesionale.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ për t'u shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Rregullorja e programit të studimit përcakton kriteret dhe mënyrat e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve. Kriteret dhe format e vlerësimit të studentit përcaktohen në planin mësimor dhe në syllabusin e secilës lëndë, për të cilat studentët marrin dijeni gjatë javës së parë të fillimit të studimeve (orientimit), si dhe nga secili pedagog në auditor për lëndët përkatëse.</i> - <i>Studentët njoftohen në fillim të çdo semestri me format dhe kriteret e vlerësimit. Ka vend që në syllabuse të përfshihen më shumë detaje mbi kriteret e vlerësimit të secilit komponent.</i> - <i>Rregullorja e programit përcakton metoda të vazhdueshme, dinamike e të larmishme për testimin dhe vlerësimin e dijeve. Sugjerohet që të ketë më shumë larmi të vlerësimit, duke mos aplikuar të njëjtat forma vlerësimi për çdo lëndë.</i> 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	


<p>Standardi III.3</p>	
<p>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>





<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi i njohurive dhe dijeve të studentëve realizohet përmes komponentëve të vazhdueshëm që reflektohet në vlerësimin përfundimtar të secilit student për lëndën përkatëse. Kriteret, përqindjet, si dhe sistemi i vlerësimit është i rregulluar dhe paraqitur në përmbajtjen e çdo syllabusi. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit akademik, elementet e përcaktuar në syllabusin e lëndës, përbëjnë 50% të vlerësimit të studentit, kurse vlerësimi përfundimtar përbën 50% të vlerësimit të studentit, raporte këto të përcaktuar në rregulloren e IAL si dhe në atë të programit të studimit (<i>Evidenca 2, kreu VII; Evidenca shtesë 9, neni 17; Evidencat “Syllabuset e lëndëve”</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Programi ka akses dhe përdor platformën “Google Classroom”, e cila, sipas RVB, f. 28, është përdorur kryesisht gjatë periudhës së pandemisë së shkaktuar nga Covid-19 për kryerjen e mësimit online si dhe vlerësimin elektronik të studentëve. Programi shoqërohet nga një manual udhëzues mbi përdorimin e këtij sistemi dhe ofron kushtet për parandalimin e abuzimit dhe rrit transparencën.</p> <p><i>Evidenca 44; Evidenca “Aneks 1. Manuali i përdorimit të Google Classroom pedagogu”; Evidenca “Aneks 2. Manuali i përdorimit të Google Classroom për studentët”</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga dokumentacioni i shqyrtuar si dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se vlerësimi përfundimtar i lëndës realizohet në përputhje me rregullimet e nenit 71 të ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar si dhe me përcaktimet e bëra në syllabusin e secilës lëndë (<i>Evidenca shtesë “Minutat e takimit”</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar</p>	<p>Në varësi të formatit të vlerësimit, studentët përveç notës mund të marrin edhe komente me qëllim arsyetimin e vlerësimit si dhe sugjerime për përmirësim në të ardhmen. Ky kriter përfshihet ndër të drejtat e studentëve gjatë kohës që frekuentojnë këtë program studimi (<i>Evidenca shtesë 9, neni 28</i>). Studentët kanë të drejtë të kërkojnë një sesion konsultimi me pedagogun pas provimit për të sqaruar notën apo bërë ndonjë ankesë (<i>Evidenca 2, neni 90</i>).</p>




studentin të përmirësohet në të ardhmen.	
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	<p>UniBa dhe departamenti përgjegjës për programin kanë rregulla normative sa i përket integritetit akademik, përfshirë këtu edhe plagjiaturën, duke bërë parashikime konkrete për shmangien e saj në aktet e brendshme të institucionit. Studentët marrin dijeni për këtë detyrim nëpërmjet këtyre akteve (<i>Evidenca 4, pika 6; Evidenca 5, pika 6 “Etika e kërkimit”</i>).</p> <p>Por, pavarësisht parashikimeve në aktet e brendshme rregullatore, nga vizita në institucion, gjatë takimit me stafin e pedagogëve, u konstatua se nga institucioni dhe njësia përgjegjëse për këtë program, nuk ka në përdorim një platformë të mirëfilltë antiplagjiaturë në përdorim e sipër (<i>Evidenca shtesë “Minutat e takimit”</i>).</p>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	<p>Për këtë program studimi, ndiqen rregullat e përgjithshme të UniBa mbi vlerësimin e studentëve. Sipas nenit 88 të Rregullores institucionale, provimet përfundimtare me shkrim bëhen të sekretuara. Sekretimi realizohet nga sekretaria. Provimet e sekretuara hapen pas vlerësimit të tyre nga pedagogu në njëseancë tëparashikuar për dhënien e rezultateve. Seanca në fjalë parashikohet dhe iu njoftohet studentëve nga pedagogu i lëndës ditën e provimit përfundimtar dhe nuk mund të jetë më shumë se 5 ditë kalendarike. Këto rregullime shprehen edhe në Rregulloren e programit të studimit. Vlerësimi përfshin të gjithë komponentët e përmendur në syllabusin e lëndës, sipas mënyrës së aktivizimit të studentit përgjatë periudhës së vitit akademik (<i>Evidenca 2; Evidenca shtesë 9, nenet 20-21; Evidencat “Syllabuset e lëndëve”</i>).</p>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	<p>Programi iu mundëson studentëve të ankohen në rast të pretendimeve për shkelje të të drejtave të tyre gjatë procesit të vlerësimit. Statuti i UniBa, delegon parashikimin e hollësishëm të të drejtave të studentëve në Rregulloren Akadematike (<i>Evidenca 1, neni 55</i>).</p> <p>Studenti ka të drejtë të ankohet si për procesin e zhvillimit të provimit, ashtu dhe për vlerësimin e kryer. Kështu, sipas nenit 89 të Rregullores akademike (institucionale), studentit ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit. Ankesa me shkrim i paraqitet përgjegjësit të departamentit brenda 24 orëve nga dita e zhvillimit të provimit.</p>





	Sipas nenit 90 të së njëjtës rregullore, ankimi mbi vlerësimin i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 48 orëve nga marrja dijeni për rezultatin (<i>Evidenca 2</i>).
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në vijim të përcaktimeve të bëra në Rregulloren akademike, përgjegjësi kryen verifikimet e duhura dhe kur nuk mund ta zgjidhë ankesën, njofton dekanin. Dekani, brenda 48 orëve nga njoftimi i bërë prej përgjegjësit të departamentit, ngre një komision ad hoc, i cili kryen verifikimin e pretendimeve të studentit. Komisioni, me miratimin e dekanit, përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit ose përsëritjen e provimit me komision të miratuar po nga dekanin (<i>Evidenca 2, neni 90</i>). Gjatë vizitës në institucion, u konfirmua se raste të paqartësisë për vlerësimin janë zgjidhur gjatë konsultimit të bërë me pedagogët e lëndës dhe nuk ka asnjë rast që ankimi të ketë ndjekur rrugët e përcaktuara në nenin 90 të Rregullores institucionale. Në këto kushte, nuk ka praktika të arkivuara për këtë qëllim (<i>Evidenca shtesë "Minutat e takimit"</i>).
Konkluzione	<i>GVJ për t'u shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkimore.</i> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Testimi dhe vlerësimi i njohurive dhe dijeve të studentëve realizohet përmes komponentëve të vazhdueshëm që reflektohet në vlerësimin përfundimtar të secilit student për lëndën përkatëse. Kriteret, përqindjet, si dhe sistemi i vlerësimit është i rregulluar dhe paraqitur në përmbajtjen e çdo syllabusi si dhe bazohet në përcaktimet ligjore e nënligjore në fuqi.</i> - <i>Për të kryer vlerësimin, IAL dëshmon se është në gjendje të përdorë dhe platforma elektronike.</i> - <i>Vlerësimet jepen në përputhje me meritat e secilit student, sipas përcaktimeve në syllabus, iu komunikohen atyre në afatet e parashikuara si dhe mund të shoqërohen me sugjerie që ndihmojnë studentin për t'u përmirësuar.</i> - <i>IAL ka bërë parashikimet e duhura në aktet e brendshme rregullatore për të shmangur dhe parandaluar plagjiaturën, por nuk ka një sistem të ngritur për këtë qëllim. GVJ sugjeron marrjen e masave konkrete për ngritjen e një sistemi antiplagjiaturë.</i>





	- Vlerësimi me notë mund të ankimohet nga studenti sipas procedurave të detajuara në Rregulloren akademike të institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi ka strukturë të përshtatshme për t'iu siguruar studentëve njohuri teorike, analitike dhe praktike mbi fushën e studimit në të drejtën tregtare dhe të drejtën penale e kriminologji. Lëndët bazë dhe ato mbështetëse kryesisht mbulojnë aspektet teorike, historike, metodologjike si dhe praktike të fushave në fjalë. Programi ofron mundësi praktike profesionale dhe mobiliteti dhe shfrytëzon bashkëpunimet ndërkombëtare për t'i shkathtësuar studentët edhe në aspektin profesional (<i>Evidenca shtesë 9; Evidencat "Syllabuset e lëndëve"</i>).
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi garanton zhvillimin e një sërë aftësive në fushat kërkimore, analitike dhe profesionale përmes leksioneve, punës në grup të studentëve dhe programeve shkëmbyese të mobilitetit, gjë e cila u konfirmua edhe gjatë takimeve me stafin akademik dhe studentët (<i>Evidenca 14; Evidenca shtesë 3; Evidenca shtesë 19; Evidenca shtesë "Minutat e takimit"</i>).
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lëndë, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të	Studentët informohen nga pedagogu i secilës lëndë lidhur me kompetencat dhe aftësitë që secila lëndë synon të krijojë tek ta, sipas programeve përkatës. Rregullorja e programit i udhëzon pedagogët të zhvillojnë lëndët përmes metodave dhe përmbajtjes të cilat iu mundësojnë studentëve nxënien e dijes dhe fitimin e aftësive të përcaktuara për programin në fjalë. Në fund të çdo semestri, pedagogët dhe studentët diskutojnë dhe vlerësojnë




<p>rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>përmbushjen e objektivave të secilës lëndë(<i>Evidencat "Syllabuset e lëndëve"; Evidenca shitesë "Minutat e takimit"</i>).</p> <p>Lëndët bazë dhe ato mbështetëse të programit kanë të parashikuar sesione në fund të çdo semestri për të diskutuar mbi formatin e provimeve si dhe mbarëvajtjen e tyre. Gjithashtu, pedagogët janë në dispozicion të studentëve për konsultime përpara provimit, saherë qërezulton e nevojshme (<i>Evidenca shitesë "Minutat e takimit"</i>).</p> <p>Përgjatë periudhës së pandemisë, evidentohet se janë zhvilluar orë konsultuese për të diskutuar çështje të ndryshme të vëna në dukje nga studentët si dhe njohuritë e fituara prej tyre gjatë semestrit (<i>Evidenca shitesë 18</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve janë të ndërtuar në një mënyrë të tillë që tregojnë se përmbajtja e leksioneve si dhe format e vlerësimit janë ndërthurur për t'u ofruar studentëve mundësinë e zhvillimit të aftësive teorike, analitike dhe profesionale për lëndët përkatëse. Praktika profesionale zë një vend të rëndësishëm në këtë program studimi (<i>Evidenca 6; Evidenca shitesë 4; Evidenca shitesë 4.1; Evidenca shitesë 8</i>).</p> <p>Personeli akademik nxit punën në grup nëpërmjet hulumtimit të rasteve dhe ofron udhëzime për planifikimin, shkrimin dhe prezantimin e projekteve të përbashkëta kërkimore. Po ashtu, syllabuset e lëndëve kanë pjesëmarrjen si komponent të vlerësimit të vazhdueshëm. Nga ana tjetër, nuk ofrojnë detaje të mjaftueshme mbi teknikat dhe metodat e punës në grup. <i>Syllabuset duhet të ofrojnë më shumë udhëzime mbi aktivitetet e punës në grup dhe kriteret e vlerësimit të pjesëmarrjes aktive</i>(<i>Evidencat "Syllabuset e lëndëve"; Evidenca shitesë "Minutat e takimit"</i>).</p> <p>Pjesëmarrja aktive në diskutimet gjatë leksioneve është hapësira kryesore ku studentëve iu jepet mundësia për shprehje dhe zhvillim të ideve inovative. Format e tjera të vlerësimit, po ashtu, ofrojnë hapësirë për të paraqitur ide teorike dhe praktike për fushën e lëndës (<i>Evidencat "Syllabuset e lëndëve"</i>).</p> <p>Studentët e këtij program përfitojnë nga mundësia për të aplikuar për shkëmbim akademik dhe mobilitet falë marrëveshjeve bashkëpunuese që UniBa ka nënshkruar me universitete të huaja. Bashkëpunimi me jashtë dhe mobiliteti i</p>




	<p>studentëve realizohet përmet Erasmus+ si dhe marrëveshjeve bilaterale institucionale të UniBa. Personeli akademik si dhe Zyrat në shërbim të studentëve iu ofrojnë këtyre të fundit udhëzime e asistencë për aplikim për mobilitet (<i>Evidenca 13; Evidenca 14; Evidenca 15; Evidenca 39; Evidenca shtesë 3; Evidenca shtesë "Minutat e takimit"</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Programi iu ofron studentëve qasje në aktivitete ekstra-kurrikulare, përfshirë këtu ndjekjen e leksioneve të hapura nga akademikë të huaj, konferenca shkencore si dhe ngjarje të tjera për promovim dhe ngritje të rrjetëve profesionale (<i>Evidenca "Raport i veprimtarisë së departamentit 21 – 22"; Evidenca shtesë 19; Evidenca shtesë 20</i>).</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparura kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Programi iu ofron studentëve hapësirat dhe mundësitë për të zhvilluar ide inovative dhe kërkimore (<i>Evidenca 1, neni 49</i>). Në programin objekt vlerësimi është e përfshirë si lëndë e veçantë, ajo e "Metodave cilësorë të kërkimit" (<i>Evidenca "Syllabus Metodave të kërkimit"</i>). UniBa organizon ngjarje dhe konferenca të veçanta për të nxitur pjesëmarrjen dhe zhvilluar aftësi të reja për studentët, duke iu krijuar atyre mundësitë që të ndjekin leksione dhe aktivitete kërkimore me kërkues dhe profesionistë të huaj (<i>Evidenca shtesë 20</i>).</p> <p>IAL mbështet këto studime nëpërmjet strukturave të ngritura për këtë qëllim, të cilat shprehen në aktet e brendshme të tij (<i>Evidenca 3</i>), si dhe janë pasqyruar edhe në faqen elektronike të institucionit: https://umb.edu.al/kerkimi-shkencor-ne-uniba.html.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ për t'u shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Programi ka strukturë të përshtatshme për t'iu siguruar studentëve njohuri teorike, analitike dhe praktike mbi fushën e studimit në të drejtën tregtare dhe të drejtën penale e kriminologji.</i> - <i>Në fund të çdo semestri, pedagogët dhe studentët diskutojnë dhe vlerësojnë përmbushjen e objektivave të secilës lëndë, gjë që realizohet gjithashtu gjatë gjithë vitit akademik. Këto</i>





	<p>vlerësime dhe diskutime janë kryer edhe gjatë periudhës së pandemisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Syllabuset e lëndëve janë të ndërtuar në një mënyrë të tillë që tregojnë se përmbajtja e leksioneve si dhe format e vlerësimit janë ndërthurur për t'iu ofruar studentëve mundësinë e zhvillimit të aftësive teorike, analitike dhe profesionale për lëndët përkatëse. Syllabuset duhet të ofrojnë më shumë udhëzime mbi aktivitetet e punës në grup dhe kriteret e vlerësimit të pjesëmarrjes aktive. - Universiteti siguron pjesëmarrjen në veprimtari të ndryshme për studentët, garanton kërkimin shkencor, mobilitetin, nëpërmjet marrëveshjeve dhe strukturave të ngritura për këtë qëllim. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Programi i studimit konsiderohet i përfunduar vetëm kur studentët mbrojnë me sukses temën e diplomës para një komisioni të posaçëm. UniBa, ku është i vendosur programi në fjalë ka udhëzime të detajuara për procedurat e përgatitjes së mbrojtjes së provës finale për diplomimin e studentëve, të cilat janë parashikuar në Rregulloren akademike si dhe atë të programit të studimit (<i>Evidenca 2, neni 98; Evidenca 5, nenet 16, 22-23</i>).</p> <p>Në përputhje me delegimet e Rregullores së programit të studimit, IAL ka detajuar në mënyrë të hollësishme procedurat e përgatitjes, të udhëheqjes, monitorimit, prezantimit dhe të vlerësimit të temës së diplomës, ku parashikohen po ashtu të drejtat dhe detyrat e personave të përfshirë në këtë proces (<i>Evidenca 5</i>). Procedurat për mbrojtjen e diplomës janë publike dhe iu komunikohen studentëve nga ana e pedagogëve dhe strukturave të tjera të universitetit, konfirmuar gjatë takimeve me stafin dhe studentët (<i>Evidenca shtesë "Minutat e takimit"</i>).</p>





	Të dhëna gjenden dhe në faqen online të universitetit: https://feqd.umb.edu.al/ .
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Procedurat për zhvillimin, shkrimin, dhe mbrojtjen e tezës së diplomës iu bëhen të ditura studentëve përgjatë ciklit akademik. Studenti udhëhiqet nga një pedagog me përvojë në fushën e temës së përzgjedhur. Studentët asistohen përmes takimeve dhe komunikimeve me e-mail me pedagogët udhëheqës. Mbrojtja e temës së diplomimit është publike (<i>Evidenca 5, pikat 2.3 dhe 7.1</i>).
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Në përputhje me nenin 100 të Rregullores akademike, për përmbylljen e studimeve me temë, departamenti propozon komisionin përkatës, i cili duhet të ketë jo më pak se 3 anëtarë nga stafi i departamentit. Për këtë lloj program studimi, MSH, anëtarët duhet të kenë gradën shkencore Dr. Komisioni miratohet nga dekani i fakultetit nëpërmjet një vendimi ku përcaktohen data dhe ora e provimit. Ky vendim i komunikohet edhe sekretarisë, me qëllim që të marrë masat për të përgatitur fletët e vlerësimit (<i>Evidenca 2; Evidenca shitesë 22</i>). Për të kryer vlerësimin, komisioni ndjek një sërë kriteresh, që shprehen në pikët përkatëse, sipas rregullave të përcaktuara në Paketën e provës finale (<i>Evidenca 5</i>).
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Personeli akademik është i angazhuar dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temës së diplomës. GVJ konstaton se përdoret një qasje e kombinuar ku pedagogët përkatës si dhe studentët bashkëpunojnë për përzgjedhjen e temave të diplomës në të cilat ata kanë interes, ekspertizë, dhe janë në gjendje të udhëheqin dhe ta mbyllin me sukses këtë proces. Në fund, përcaktimi i udhëheqësve të temave të diplomës bëhet nga Komiteti Shkencor i programit (<i>Evidenca 2, neni 98; Evidenca 5</i>). Pedagogët udhëheqës të temave të diplomave asistojnë studentët përgjatë gjithë procesit të përpilimit, hulumtimit dhe shkrimit të temës. Ata përkujdesen që studentët të respektojnë standardet dhe procedurat e temës. Në përfundim të punës, pedagogu udhëheqës plotëson aktet “Vlerësim i udhëheqësit shkencor” dhe “Leje për mbrojtjen e mikrotezës” (<i>Evidenca shitesë 23; Evidenca “Leje për mbrojtje mikroteze”</i>).




	Temat që nuk respektojnë formatin, rregullat si dhe etikën dhe integritetin akademik (përfshirë plagjiaturën) nuk pranohen dhe nuk procedohen për mbrojtje publike (<i>Evidenca 5, pika 7.3</i>).
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	<p>UniBa dhe departamenti i drejtësisë, përgjegjës për këtë program studimi, u sigurojnë studentëve mbështetje në tri drejtime, gjatë procesit të hulumtimit dhe shkrimit të temës.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Së pari, ofron hapësirën kërkimore, nëpërmjet shërbimit të bibliotekës fizike dhe platformave elektronike për të konsultuar tekste, libra, artikuj dhe materiale të tjera të vlefshme për këtë qëllim (<i>Evidenca shtesë 27; Evidenca "Aneks 8. Platforma e bibliotekës online"</i>); - Së dyti, pedagogu udhëheqës ofron mbështetje akademike dhe metodologjike gjatë gjithë procesit të kërkimit dhe shkrimit të temës (<i>Evidenca 5</i>); - Së treti, UniBa asiston studentët gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave përmes shfrytëzimit të bashkëpunimeve institucionale brenda dhe jashtë vendit (<i>Evidenca 15; Evidenca shtesë 3</i>);
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studentit vlerësohet me notë.	Çdo temë diplome vlerësohet nga komisioni i posaçëm që ndjek një listë kriteresh dhe bëhet me sistemin e pikëve (1-100) (<i>Evidenca 5, pikat 7.2.2 dhe 7.2.3</i>).
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	<p>Me përfundimin dhe mbrojtjen me sukses të temës së diplomës dhe përmbushjes të të gjithë detyrimeve të tjerë, studentët pajisen me diplomën përkatëse të shoqëruar me suplementin e saj. Diploma nënshkruhet nga dekani i fakultetit dhe rektori i UniBa-s (<i>Evidenca 2, neni 101; Evidenca shtesë 9, neni 23; Evidenca 5; Evidencat shtesë "Forma e diplomës"</i>).</p> <p>Në përfundim të studimeve, studentëve iu vihet në dispozicion tema e diplomës dhe suplementi zyrtar, ky i fundit edhe në gjuhën angleze (<i>Evidenca 2, neni 103</i>). Kopja e programit të studimit, planit mësimor dhe syllabuseve, iu vihet në dispozicion studentëve të interesuar që kanë paraqitur kërkesë për këtë qëllim (<i>RVB, f. 35</i>).</p>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të	UniBa ruan kopje të dokumentacionit të studentëve dhe të procesit mësimor, në përputhje me sistemin e brendshëm arkivor, përfshirë këtu mbrojtjen e të dhënave personale. Të





dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	dhënat administrohen në sekretarinë e institucionit dhe zyrën e arkivës, veprimtaria e të cilave është rregulluar me akte të brendshme, zyra të cilat mundësojnë dhënien e informacioneve të nevojshme për studentin (<i>Evidenca 1, neni 57; Evidenca 2, kreu III; Evidenca 34; Evidenca "Rregullore e Protokoll-Arkivës"</i>).			
Konkluzione	<p><i>GVJ për t'u shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>UniBa ka hartuar udhëzime të detajuara për procedurat e përgatitjes së mbrojtjes së provës finale për diplomimin e studentëve, të cilat janë parashikuar në Rregulloren akademike si dhe atë të programit të studimit. Këto procedura janë bërë publike si dhe iu komunikohen në kohën e duhur studentëve.</i> - <i>Studenti udhëhiqet nga një pedagog me përvojë në fushën e temës së përzgjedhur. Për përmbylljen e studimeve me temë, departamenti propozon komisionin përkatës, i cili duhet të ketë jo më pak se 3 anëtarë nga stafi i departamentit.</i> - <i>Personeli akademik është i angazhuar dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temës së diplomës, kurse pedagogët udhëheqës të temave të diplomave asistojnë studentët gjatë gjithë procesit të përpilimit, hulumtimit dhe shkrimit të temës, duke u kujdesur që studentët të respektojnë standardet dhe procedurat e temës.</i> - <i>Çdo temë diplome vlerësohet nga komisioni i posaçëm që ndjek një listë kriteresh që shprehet në pikëzimin përkatës.</i> - <i>Procesi i rregullt për punimin e temës së diplomës përmbillet me pajisjen me diplomë të studentit, sipas formatit të miratuar dhe me suplementin përkatës. Dokumentacioni mësimor dhe ai që lidhet me studentët, ruhet nga institucioni nëpërmjet strukturave të ngritura për këtë qëllim.</i> 			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1							
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.							
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve						
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka kualifikimin me tituj akademikë e grada shkencore duke përmbushur kërkesat ligjore dhe pritshmëritë e cilësisë akademike. Personeli akademik i angazhuar në këtë program ka kualifikime brenda dhe jashtë vendit, me tituj dhe grada shkencore, me përvojë në fushën e mësimdhënies, në administratë dhe në sistemin e drejtësisë.</p> <p>Bazuar në informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL (<i>Tabelat permbledhese per Aneks_RVB_MSh-Penale-Kriminologji_Tregtare.docx</i>), GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit të studimit Msc në Shkenca Juridike me profile, bazuar në tabelat 6.1 – 6.3 është:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Për vitin akademik 2020- 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 11 pedagogë nga të cilët 4 PAE dhe 7 PAK (37 % /64 %) 2. Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 12 pedagogë nga të cilët 5 PAE dhe 7 PAK (42 % /58 %) 3. Për vitin akademik 2022 - 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 11 pedagogë nga të cilët 5 PAE dhe 6 PAK (45.4 % / 54.6 %) 						
	Tituj/grada		2020 - 2021		2021 - 2022		2022 - 2023
		PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:




Prof.Dr	-	-	-	1	-	-
Prof.As.Dr	2	1	2	1	4	1
Dr/PhD	2	6	3	5	1	5
Msc	-	-	-	-	-	-
Në total	4	7	5	7	5	6

Ajo që vihet re nga të dhënat tabelore është se në këtë program studimi angazhohen staf i kualifikuar me tituj dhe grada në përputhje me kriteret ligjore.

Në vijim të sa më lart, GVJ vëren se fushat akademike të përgjithshme dhe specifike të stafit akademik kanë përputhje si me programin e studimit ashtu edhe me lëndët specifike që ato mbulojnë (*Evidenca shtesë 5; Evidenca shtesë 9*).

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.


Programi i studimit është organizuar në leksione, seminare/ushtrime dhe praktika profesionale me ngarkesën përkatëse në kredite ECTS. Ndarja në kategori (A në E) dhe ngarkesa në kredite (në %) për veprimtaritë formuese është në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar.

Bazuar në informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL (*Tabelat permbledhese per Aneks_RVB_MSh-Penale-Kriminologji_Tregtare.docx*), në tabelat 12.1 – 12.3, rezultoi se raporti i ngarkesës mësimore (orë mësimore) PAE/PAK është si më poshtë:


Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)
2020-2021	870	616	254	70% / 30 %
2021-2022	515	331	184	65% / 35%
2022-2023	1024	916	108	89% / 11%

Kërkesa ligjore që stafi akademik PAE të mbulojë të paktën 70% te ngarkesës përmbushet plotësisht për vitin akademik 2020-2021 dhe 2022-2023. Ky kriter nuk përmbushet plotësisht për vitin


	2021-2022. Gjithsesi, në vitin 2022-2023 ky kriter është rritur deri në masën 89%.
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	<p>Për mbulimin e lëndëve të programit, pjesa më e madhe e lëndëve realizohet nga personel akademik i brendshëm, gjë që siguron dhe garanton qëndrueshmërinë dhe kualifikimin e personelit akademik të brendshëm për të gjithë periudhën e akreditimit (<i>Evidenca shtesë 24.1</i>).</p> <p>Me secilin anëtar të personelit akademik janë lidhur kontratat përkatëse të punësimit si dhe rezultojnë të mbuluar me sigurime shoqërore dhe shëndetësore, gjë që u konfirmua gjatë vizitës në institucion, në zyrën e burimeve njerëzore.</p> <p>(<i>Evidenca 8; Evidenca shtesë "Minutat e takimit"</i>)</p>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>Procesi i rekrutimit fillon me identifikimin e nevojës për personel akademik nga njëzia bazë akademike, ku përcaktohen kriteret e përgjithshme e ato specifike, si dhe fushëveprimi dhe lëndët që kërkohet nga personel akademik. Kjo kërkesë i përcillet Zyrës së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, para fillimit të vitit akademik, për të bërë shpalljen për vendin vakant, pas konfirmimit nga Sekretari i Përgjithshëm. Shpallja publike bëhet në rrjetet sociale të universitetit dhe në faqen zyrtare të internetit të IAL, në seksionin përkatës: https://umb.edu.al/zyra-e-menaxhimit-te-burimeve-njerezore.html.</p> <p>Në përfundim të afatit të shpallur, Zyra bën gjenerimin e listës së aplikantëve që i dërgohet në vijim një komisioni të posaçëm, i cili kryen vlerësimin paraprak të aplikantëve. Pas vlerësimit paraprak, procesi i rekrutimit kalon nëpër dy faza të tjera dhe në përfundim është Komisioni i cili merr vendim për aplikantin fitues. Marrëdhënia formalizohet me lidhjen e kontratës së punës, e cila nënshkruhet nga rektori (<i>Evidenca 1, neni 51; Evidenca 7</i>).</p> <p>Sa i përket personelit akademik me kohë të pjesshme, njësia kryesore, sipas nevojave të propozuara nga njëzia bazë, i kërkon rektorit miratimin e personelit akademik me kohë të pjesshme. Kriteret e rekrutimit për këtë kategori të personelit janë të përcaktuar në aktet e brendshme rregullatore (<i>Evidenca 1, neni 51</i>).</p> <p>Rregulla të posaçme gjenden në manualin e menaxhimit dhe për personelin ndihmës-akademik dhe administrativ (<i>Evidenca 7</i>).</p>




<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, janë të punësuarit në zyrat përgjegjëse, të cilët merren me mirëmbajtjen e infrastrukturës në dispozicion të programit të studimit, që mirëmbajnë gjithashtu dhe çdo mjedis mësimor. Për qëllime të asistencës në lidhje me burimet e të dhënave, përdorimin e bibliotekës online, etj., gjatë vizitës së GVJ, angazhimi nga ana e personelit të bibliotekës dhe stafit administrativ të institucionit, ishte i dukshëm (<i>Evidenca shtesë 25; Evidenca shtesë “Minutat e takimit”</i>).</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore në UniBa, e cila administron të dhënat lidhur me personelin e punësuar, është ngritur dhe funksionon në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin Nr. 80/2015, të ndryshuar, dhe aktet e brendshme të universitetit.</p> <p>Nga aktet e vënë në dispozicion rezultojnë që institucioni disponon të dhënat e nevojshme që përfshijnë dokumentacionin lidhur me punësimin dhe kualifikimet e personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ. Të dhënat që përfshijnë dokumentacionin lidhur me punësimin dhe kualifikimet e personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ, administrohen nga zyra e burimeve njerëzore në nivel institucional, e cila, ka vënë në dispozicion të GVJ dosje të personelit, të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme. Nga dokumentet e administruar në dosje u vu re që ishin në përputhje me llojet e dokumenteve të përcaktuar në aktet e brendshme rregulluese (<i>Evidenca 7; Evidenca shtesë “Minutat e takimit”</i>).</p> <p>Departamenti që mbulon këtë program studimi, si dhe IAL, kanë mbajtur të dhënat lidhur me angazhimin e personelit akademik si dhe kategorive të tjera të personelit (<i>Evidenca shtesë 14; Evidenca shtesë 24.1; Evidenca shtesë 25</i>).</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e</p>	<p>GVJ vëren se departamenti ka angazhuar pedagogë të posaçëm për mbikëqyrjen e praktikës, e cila zhvillohet në institucionet me të cilët UniBa ka marrëveshje bashkëpunimi. E njëjta praktikë ndiqet edhe për udhëheqjen e diplomës për të cilën angazhohet staf akademik me tituj dhe grada. Në këtë kuadër puna e studentëve</p>




<p>kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>drejtohet edhe nga Paketa e provës finale për përgatitjen dhe mbrojtjen e tezës në këtë program të ciklit të dytë. (Evidenca shtesë 9, nenet 12, 16; Evidenca 5; Evidenca “Paketa e provës finale”; Evidenca shtesë 4; Evidenca shtesë 4.1).</p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Në përputhje me marrëveshjet e lidhura nga UniBa me institucione publike dhe jopublike, për kryerjen e praktikave profesionale, përcaktohen dhe mbikëqyrësit në ambientin pritës, të cilët ndihmojnë studentët për përmbushjen e detyrimeve gjatë kësaj periudhe. Në funksion të efikasitetit të mbikëqyrjes, këta persona marrin pjesë dhe nëvlerësimin e praktikës profesionale, duke plotësuar një formular për këtë qëllim. (Evidenca shtesë 4; Evidenca shtesë 4.1; Evidenca 6; Evidenca “Paketa e praktikës”).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ për t’u shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka kualifikimin me tituj akademikë e grada shkencore duke përmbushur kërkesat ligjore dhe pritshmëritë e cilësisë akademike.</i> - <i>Fushat akademike të përgjithshme dhe specifike të stafit akademik kanë përputhje si me programin e studimit ashtu edhe me lëndët specifike që ato mbulojnë.</i> - <i>Kërkesa ligjore që stafi akademik PAE të mbulojë të paktën 70% te ngarkesës përmbushet plotësisht për vitin akademik 2020-2021 dhe 2022-2023 Ky kriter nuk përmbushet plotësisht për vitin 2021-2022. Gjithsesi, në vitin 2022-2023 ky kriter është rritur deri në masën 89%.</i>





	<p>- Në programin e studimit janë angazhuar më së shumti staf akademik i brendshëm. Institucioni ka formalizuar në aktet e tij hapat e punësimit të personelit si dhe mban në mënyrë të rregullt dokumentacionin e punësimit të tyre.</p> <p>- Departamenti ka angazhuar pedagogë të posaçëm për mbikëqyrjen e praktikës, e cila zhvillohet në institucionet me të cilët UniBa ka marrëveshje bashkëpunimi. E njëjta praktikë ndiqet edhe për udhëheqjen e diplomës për të cilën angazhohet staf akademik me tituj dhe grada.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>UniBa disponon infrastrukturën e përshtatshme për plotësimin në mënyrë efektive të programit mësimor dhe funksioneve mbështetëse të tij. Mësimdhënia për programet e studimit të ofruar nga Departamenti i Drejtësisë realizohet në kampusin 2 të këtij universiteti, të gjendur në rrugën “Frang Bardhi”, Tiranë, i cili shtrihet në një sipërfaqe 6577 m², me sipërfaqe të shfrytëzueshme 6451 m². Kampusi përbëhet nga 2 godina dhe mjedise sportive. Vlerësimi është kryer në ambientet në fjalë, ku u zhvillua vizita nga GVJ si dhe ku zhvillohet programi i studimeve, objekt vlerësimi. Sipas të dhënave të administruara dhe të konfirmuara gjatë vizitës, institucioni siguron në këto ambiente sipas godinave, 7 klasa leksioni/auditore, 14 auditore, 16 zyra për stafin akademik dhe ndihmës akademik, 7 zyra për stafin akademik dhe ndihmës akademik, gjithsej 21 laboratorë, etj. GVJ konstatoi një sipërfaqe të mjaftueshme në funksion të sallave për leksione, etj., në raport me numrin e studentëve, dhe të mjaftueshëm për zyra, sa i përket stafit.</p> <p>Sipas këtyre të dhënave, universiteti vë në dispozicion 1507,3 m² si salla leksioni/seminari për studentët. Bibliotekat kanë sipërfaqe tërësore 97,3 m² (Evidenca shtesë 26).</p>




	<p>Sallat janë të pajisura me ndriçim dhe me aksesoret e nevojshëm teknologjikë për zhvillimin normal dhe bashkëkohor të veprimtarisë për të cilën janë destinuar. Ambientet janë të pajisura me dritare dhe menjë sistem të përshtatshëm ajrimi dhe kondicionimi. Institucioni disponon sipërfaqe parkimi, ambiente çlodhëse për studentët dhe mjedise hidrosanitare, të pajisur me infrastrukturën e nevojshme. Nga vizita në institucion u konstatua se institucioni siguron aksesueshmëri, në kuptimin infrastrukturor, për personat me aftësi të kufizuara</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga vizita në institucion u vërejt se UniBa zotëron ambientet e duhura për realizimin e programit mësimor të studimeve të ciklit të dytë Master i shkencave, ku klasat dhe sallat janë të pajisura me pajisjet përkatëse elektronike dhe të teknologjisë së informacionit. Pajisjet në fjalë, video projektorë, TV, projektorë, kompjutera, pajisje të tjera teknologjike, lehtësojnë procesin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies. (<i>Evidenca shtesë 26; Evidenca shtesë "Minutat e takimit"</i>).</p> <p>Në godinë funksionon normalisht shërbimi i internetit <i>wireless</i>, i aksesueshëm nga studentët dhe nga stafi i institucionit, gjë që u konstatua dhe nga GVJ. Rezulton që institucioni ka siguruar e vënë në shfrytëzim pajisjet e duhura e të nevojshme, në funksion të programit të studimeve Master Shkencor në përputhje me rregullimet e bëra në nenin 9 të Statutit të tij (<i>Evidenca 1</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Në godinë përfshihen laboratorët, sallat e studimit, auditorë të madhësive të ndryshme për zhvillimin e leksioneve, seminareve, orëve praktike, leksioneve të hapura, etj.</p> <p>Gjithashtu, janë të pajisura me pajisje kompjuterike, projektorë, etj., dhe lehtësojnë përdorimin e metodave të larmishme të mësimdhënies. Ambientet konsiderohen të përshtatshëm për zhvillimin e leksioneve të hapura dhe për aktivitete të tjera të ngjashme. (<i>Evidenca shtesë 26</i>)</p>




<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Në përputhje me programin e studimit, IAL nuk ka parashikuar laboratorë informatike; gjithsesi universiteti disponon dy laboratorë të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale. Gjithashtu, ka siguruar ambientin e nevojshëm për përdorimin e pajisjeve kompjuterike në sallën e bibliotekës, ku studentët kanë mundësinë që të kryejnë detyra e punime të ndryshme, duke shfrytëzuar programe profesionale, që lehtësojnë punën e tyre (<i>Evidenca shtesë 26; Evidenca shtesë 27</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Falë projekteve ku merr pjesë, por edhe bashkëpunimeve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, kapacitetet e UniBa mundësojnë mjedise të përshtatshme për realizimin e veprimtarive praktike dhe aktiviteteve të tjera. IAL garanton infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarive praktike në institucion si për shembull leksione të hapura, seminare, tryeza të rrumbullakëta apo workshop-e sikurse dhe bashkëpunon me institucione dhe organizata të tjera në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve.</p> <p>(<i>Evidenca 15; Evidenca shtesë 4; Evidenca shtesë 4.1</i>).</p> <p><i>Në lidhje me këto marrëveshje, GVJ sugjeron lidhjen e marrëveshjeve me institucione të tillë si Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Spitale Psikiatrike si dhe institucione të tjerë, ku mund të realizohen praktika në lidhje me probleme të caktuara e specifike kriminologjike, në funksion të përmbushjes së objektivave të këtij programi studimi.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ për t'u shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.</i></p> <p>- <i>Institucioni përmbush kënaqshëm kërkesat sa i përket infrastrukturës së duhur për realizimin e programit të ciklit të dytë të studimeve, Master Shkencor. Mjediset zotërojnë cilësinë e përshtatshme për realizimin e programit mësimor</i></p>





	<p><i>e praktik, sallat janë të përshtatshme dhe studentët kanë lehtësi në akses.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>IAL ka vendodhje të qëndrueshme, e cila përfshin si mjedisin administrativ, ashtu dhe mjediset e zhvillimit të veprimtarisë mësimore.</i> - <i>Institucioni zotëron mjedise të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive akademike dhe shkencore.</i> - <i>GVJ sugjeron lidhjen e marrëveshjeve me institucione si Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve, Spitale Psikiatrike si dhe institucione të tjerë, ku mund të realizohen praktika në lidhje me probleme të caktuara e specifike kriminologjike, në funksion të përmbushjes së objektivave të këtij programi studimi.</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Nga vëzhgimi i syllabuseve të lëndëve, por edhe i titujve të bibliotekës fizike dhe <i>online</i> të institucionit vërehet se ka një përpjekje të mirë për të përfshirë në literaturë informacionin e nevojshëm për qëllimet e programit të lëndëve. Literatura e rekomanduar është e pasqyruar në syllabusin e çdo lënde. Ka lëndë që nuk kanë një literaturë të veçantë, për të cilat pedagogu sugjeron literaturë të huaj, artikuj të ndryshëm shkencorë ose materiali përgatitet nga ana e lektorit të lëndës sipas temave të përfshira. Në përgjithësi, literatura e ofruar në bibliotekë është e mjaftueshme për të përmbushur nevojat më themelore të studimit dhe kërkimit shkencor (<i>Evidencat "Syllabuset e lëndëve"</i>).
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë	Sikundër evidentohet në <i>RVB, f. 41</i> , pasurimi periodik i fondit të bibliotekës, është pjesë e politikave institucionale. Nga vizita në institucion, gjatë takimit me përfaqësues të departamentit të drejtësisë dhe stafin akademik, u referua se literatura e përdorur




<p>përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>është e përditësuar me botime të viteve të fundit. Nga departamenti janë bërë komunikime me njësinë ndihmëse të bibliotekës, me qëllim shtimin e titujve që i vlejné këtij programi të studimit, në përputhje me nevojat e lindura (<i>Evidenca shtesë 29; Evidenca shtesë "Minutat e takimit"</i>).</p> <p>GVJ i është vënë në dispozicion materiali që hedh dritë mbi përditësimin e literaturës me botime të fundit, që gjenden në bibliotekën e fakultetit (<i>Evidenca shtesë 28</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka bibliotekën e tij, e aksesueshme nga ambientet fizike ose <i>online</i>. Biblioteka zotëron fondin e saj fizik me botime/tituj në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, fond i cili pasurohet herë pas here me blerje/hyrje të reja në varësi të nevojave të evidentuara nga departamenti, siç ishte dhe informacioni më i fundit i marrë gjatë vizitës në institucion. Ofrohet mundësia edhe për akses të studentëve në biblioteka <i>online</i>, pa pagesë (<i>Evidenca shtesë 27; Evidenca shtesë 28</i>).</p> <p>Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve, në kampusin 2, dy biblioteka, biblioteka është konceptuar si njësi ndihmëse, me qëllimin që të mbështesë me literaturë mësimore dhe shkencore, aktivitetin e personelit akademik, studentëve, profesionistëve si dhe kërkuesve shkencorë në përgjithësi (<i>Evidenca 1, neni 16</i>).</p> <p>Nga vizita që u realizua në bibliotekë, rezultoi që ajo është lehtësisht e aksesueshme nga të gjithë studentët. Për të përfituar nga fondi i bibliotekës, studentëve iu mundësohet regjistrimi, me të dhënat personale, dhe iu jepet një fjalëkalim për të krijuar llogarinë personale të përdorimit. Nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se biblioteka ka ambient të mjaftueshëm, me ndriçim, ajrim dhe sistem të përshtatshëm kondicionimi.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha</p>	<p>Literatura e gjendur në bibliotekë siguron botime në gjuhën shqipe, angleze dhe gjuhë të tjera. Biblioteka ka infrastrukturë për aksesimin e titujve të librave në bibliotekat online si për shembull EconBiz, JSTOR, etj., të cilat ofrojnë një larmi titujsh në fushën e studimeve në të drejtën tregtare, penale dhe të kriminologjisë (<i>Evidenca shtesë 27; Evidenca shtesë 28</i>).</p> <p>Po ashtu, institucioni ka mundësuar një platformë digjitale të menaxhimit të librit, me anë të cilit mund të bëhet kërkimi i titujve të librave fizikë që ndodhen në bibliotekë, kërkimi i</p>





<p>moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>librave elektronikë dhe punimet e diplomave, të konsultueshme në faqen elektronike të IAL: https://umb.edu.al/biblioteka.html.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Regjistrimi dhe përdorimi i infrastrukturës dhe shërbimeve në bibliotekë, përfshirë bibliotekat online, ku studentët dhe personeli akademik e kërkimor-shkencor mund të gjejnë larmi tekstesh e punimesh në përputhje me programin e studimit, është pa pagesë (<i>Evidenca "Aneks 8. Platforma e bibliotekës online"; Evidenca shtesë 27</i>).</p> <p>GVJ kërkoi aksesimin në bibliotekat online dhe bazat e tjera të të dhënave, gjatë vizitës në institucion, gjë e cila rezultoi plotësisht e realizueshme, në përputhje me sa deklaruar nga institucioni në RVB(<i>Evidenca shtesë "Minutat e takimit"</i>).</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Gjatë vizitës së kryer në institucion, GVJ konstatoi që biblioteka e institucionit është e pajisur me pajisjet e duhura teknike, tavolinat e punës si dhe programet kompjuterike që mundësojnë shfrytëzimin e saj nga studentët (<i>Evidenca shtesë "Minutat e takimit"</i>).</p> <p>Njëra prej hapësirave të saj përmban zonën e kompjuterave dhe aksesorët e tjerë të nevojshëm. Databaza e bibliotekës gjendet dhe në formatin elektronik në faqen elektronike zyrtare të institucionit(https://umb.edu.al/biblioteka.html). Në platformën dedikuar kësaj biblioteke gjendet katagorizimi i titujve të librave sipas fushave të studimit, monitorimi i librave fizik (kërkesat, tërheqja, afati i dorëzimit, vonesat, humbja apo dëmtimi), ofrimi i burime digjitale (biblioteka digjitale, revista apo libra digjital), informacione lidhur me bibliotekën dhe orientime mbi bibliotekat ndërkombëtare.</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Oraret e punës së bibliotekës në UniBa janë të disponueshme për studentët nga dita e Hënë deri ditën e Premte në orarin 08.00 – 16.30, kur të interesuarit mund të kërkojnë dhe t’u shërbehet me libra. Gjatë orarit 16.30-19.45, ambientet e bibliotekës mund të përdoren për studim (<i>RVB, f. 44</i>). Oraret e ofrimit të këtij shërbimi vijnë në përputhje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor. Orari është i shpallur në hyrje të bibliotekës.</p>





<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Nga takimi i zhvilluar në institucion me punonjësen e bibliotekës u konstatua se në përputhje me sa parashikohet në rregulloren për funksionimin e saj, kryhen raportime të përbashkëta me njësinë bazë që ofron programin e studimit lidhur me tekstet e gjendur në bibliotekë si dhe çdo literaturë tjetër fizike, por dhe për titujt që sigurohen <i>online</i>. Mbi bazën e të dhënave të nxjerra, merren masat e nevojshme dhe ndiqen procedurat përkatëse për përditësimin, por dhe për shkallën e shfrytëzimit të bibliotekës si nga personeli, ashtu dhe nga studentët. Këto analiza shërbejnë për të evidentuar dhe titujt e rinj që duhet të pasurojnë bibliotekën. Punonjësja e bibliotekës harton listat me titujt e librave të rinj që duhet të përfshihen në fondin e bibliotekës dhe e paraqet në strukturat përgjegjëse për blerjen e tyre (<i>Evidenca shtesë 29; Evidenca shtesë “Minutat e takimit”</i>).</p> <p><i>GVJ, në funksion të ecurisë së këtij kriteri, sugjeron që nga ana e institucionit të miratohet Rregullorja e funksionimit të bibliotekës, si njësi ndihmëse, ku të përcaktohen detyrat e punonjësve të bibliotekës, të drejtat dhe detyrimet e personave që e shfrytëzojnë bibliotekën, burimet për pasurimin e bibliotekës, procedura për shtimin e literaturës në bibliotekë dhe për përditësimin e fondit të saj, etj.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkimore.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Institucioni ka krijuar një fond të konsiderueshëm në bibliotekën e tij, me tekste në fushën e drejtësisë. Titujt zgjidhen nga departamenti që ofron programin e studimit.</i> - <i>Në bibliotekë gjenden botime të ndryshme dhe sigurohet akses në disa faqe online, që i shërbejnë kërkimit shkencor, përgatitjes së tezave, etj.</i> - <i>Biblioteka ka orare të përshtatshme të shërbimit, të lidhura me programin e studimit dhe nevojat e studentëve.</i> 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi IV.4






Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Uniba ka një sistem të menaxhimit të informacionit që realizon ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të dhënave të studentit nga regjistrimi deri në diplomim. Ky sistem shërben edhe për nxjerrjen e statistikave dhe zhvillimin e analizave përkatëse. Sekretaria mban në formë të shkruar regjistrin themeltar të studentëve dhe regjistrin e arritjeve akademike të studentit. Këto të dhëna ruhen dhe arkivohen sipas legjislacionit përkatës mbi arkivat. Në të njëjtën formë, të dhënat për studentët ruhen dhe administrohen dhe në formë elektronike.</p> <p><i>(Evidenca 44; Evidenca shtesë "Minutat e takimit")</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Strukturat përkatëse që administrojnë të dhënat lidhur me personelin e punësuar në të, janë ngritur dhe funksionojnë në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin Nr. 80/2015 dhe aktet e brendshme të UniBa. Nga aktet e vënë në dispozicion rezultojnë që institucioni disponon të dhënat e nevojshme që përfshijnë dokumentacionin lidhur me punësimin dhe kualifikimet e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. <i>(Evidenca shtesë 14; Evidenca shtesë 25)</i></p> <p>Të dhënat që përfshijnë dokumentacionin lidhur me punësimin dhe kualifikimet e personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ, administrohen nga zyra e burimeve njerëzore, e cila ka vënë në dispozicion të GVJ dosje të personelit, të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme. Nga dokumentet e administruar në dosje u vu re që ishin në përputhje me llojet e dokumenteve të përcaktuar në aktet e brendshme rregulluese <i>(Evidenca 8; Evidenca shtesë "Minutat e takimit").</i></p> <p>Departamenti që ofron programin e studimit administron të dhënat lidhur me personelin akademik si dhe veprimtaritë e kryera prej tyre, pjesëmarrjen në konferenca si dhe botimet e bëra <i>(Evidenca "Raport i veprimtarisë së departamentit"; Evidenca 21; Evidenca shtesë 20).</i></p> <p>Po ashtu, departamenti në fjalë dhe institucioni, zotërojnë të dhëna mbi partnerët e angazhuar në realizimin e programit të</p>




	studimit (<i>Evidenca shtesë 3; Evidenca shtesë 4; Evidenca shtesë 4.1</i>).
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i menaxhimit që përdoret mundëson aksesin e dedikuar për stafin dhe studentët sipas programeve të studimit duke respektuar mbrojtjen e të dhënave personale. Ky sistem ofron informacion të personalizuar për çdo përdorues, student apo pedagog (<i>Evidenca 44; Evidenca "Aneks 5: Portali studentor"; Evidenca 34; Evidenca shtesë "Minutat e takimit"</i>).
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	<p>Sistemi i menaxhimit siguron aksesin nëpërmjet llogarive personale të stafit dhe studentëve nëpërmjet platformave që përdoren për këtë qëllim. Secili student ka tashmë në dispozicion portalin e tij elektronik me akses personal nëpërmjet të cilit mund të arrijë të regjistrohet në programet e studimit, t'i frekuentojë ato dhe të verifikojë arritjet e tij personale në mënyrë konfidenciale: https://studentportal.umb.edu.al/.</p> <p>Institucioni mundëson shkëmbimin e dokumentacionit dhe komunikimin midis studentëve dhe stafit nëpërmjet këtij sistemi të menaxhimit (<i>Evidenca 44; Evidenca "Aneks 5: Portali studentor"</i>). Këto sisteme lehtësojnë komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve të studimit dhe informacionit, konfirmuar gjatë takimit me punonjëset e sekretarisë mësimore (<i>Evidenca 34; Evidenca shtesë "Minutat e takimit"</i>).</p> <p>Shkëmbimi i të dhënave dhe informacioneve ka funksionuar më së miri edhe gjatë periudhës së pandemisë, të shkaktuar nga Covid-19, nëpërmjet platformës së përdorur për këtë qëllim (<i>Evidenca 56; Evidenca shtesë 12</i>).</p>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	<p>Përmes përdorimit në nivel institucional të adresave zyrtare të komunikimit elektronik, të sistemit të platformës digjitale "Google Classroom", SIS Classter, Intranet, Gsuit, etj., garantohej komunikimi në kohë reale midis studentëve dhe stafit akademik dhe administrativ. Ky sistem realizon së fundmi edhe monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik. Sistemi është një mjet në dispozicion të analizave dhe raporteve që hartohen për organet drejtuese dhe titullarët, për të monitoruar mbarëvajtjen e procesit akademik.</p> <p>(<i>Evidencat Aneks 1; Aneks 2; Aneks 3; Aneks 4; Aneks 5; Aneks 5.1; Evidenca "Raport i veprimtarisë së departamentit"</i>).</p>

Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.

Institucioni mundëson akses në dhënien e informacionit në faqen zyrtare online të veprimtarisë së tij, <https://umb.edu.al/>, në lidhje me objektivat, programet e studimit, stafin akademik, studentët, veprimtaritë shkencore, etj. Në përputhje me standardet e vendosur në shtojcën Nr. 5 të VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së arsimit të lartë”, informacioni sigurohet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze.


Konkluzione

GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.

- *Institucioni disponon të dhënat e nevojshme dhe ka ngritur strukturat e duhura për menaxhimin e të dhënave mbi studentët që nga momenti i regjistrimit.*
- *Institucioni disponon të dhënat e nevojshme që përfshijnë dokumentacionin lidhur me punësimin dhe kualifikimet e personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ. Njësia bazë administron të dhënat lidhur me personelin akademik si dhe veprimtaritë e kryera prej tyre, pjesëmarrjen në konferenca si dhe botimet e bëra, gjithashtu mbi partnerët e angazhuar në realizimin e programit të studimit.*
- *Strukturat përgjegjëse për programin e studimit objekt vlerësimi, sekretaria mësimore dhe departamenti, mundësojnë dhënien e informacioneve e dokumentacionit të kërkuar si për personelin, ashtu dhe për studentët. Shkëmbimi i të dhënave kryhet nëpërmjet sistemit të menaxhimit që siguron llogari personale (postë elektronike) për anëtarët e personelit dhe secilin student, në faqen zyrtare elektronike të UniBa.*
- *Strukturat drejtuese dhe titullarët marrin dijeni rregullisht për veprimtaritë e kryera nga personeli akademik dhe ai administrativ.*


Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5





Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, UniBa është person juridik privat, në pronësi të shoqërisë tregtare “BARLETI Group” sh.p.k. Në funksion të përmbushjes së veprimtarisë së tij, institucioni harton në mënyrë periodike pasqyrat financiare të të ardhurave si dhe të ndarjes së burimeve financiare. Në bazë të dispozitave të ligjit Nr. 80/2015, harton planin buxhetor afatmesëm, pjesë e planit strategjik të zhvillimit të institucionit.</p> <p>Hartimi i projektbuxhetit një-vjeçar bëhet në fillim të çdo viti akademik nga administratori i institucionit, duke u mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe në planin buxhetor afatmesëm të tij, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe atyre bazë (duke mbajtur parasysh nevojat e tyre). Buxheti vjetor dhe ai afatmesëm miratohet nga Bordi i Administrimit, me propozim të senatit (<i>Evidenca 1, nenet 35/1, germa c, dhe 39</i>). Njësia kryesore dhe ajo bazë parashikojnëmbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p> <p>Burim i të ardhurave sipas statutit janë të ardhurat nga: financimet e shoqërisë “BARLETI Group”, ku përfshihen edhe të ardhurat nga tarifat e studimit dhe shërbime të tjera të ligjshme, ndihma/donacione dhe të ardhura financiare nga sektori publik, privat, shoqëria civile, subjektet ndërkombëtare, projektet e fituara dhe çdo burim tjetër i ligjshëm financiar (<i>Evidenca 1, neni 62</i>). Referuar të dhënave të sjella nga institucioni, të ardhurat faktike kryesore vijnë nga tarifat e shkollimit dhe të ardhura të tjera të shfrytëzimit (<i>Evidenca shtesë 30</i>).</p>




<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të shqyrtuar, rezulton se plani financiar, ku përfshihet dhe njësia bazë për këtë program studim, përmban mënyrën e përdorimit të fondeve, të cilët ndahen në tre kategori:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shpenzime për mësimdhënie dhe shkencë; - Shpenzime të administrimit institucional dhe, - Shpenzime të përgjithshme operative. <p>Ndarja dhe mënyra e përdorimit të fondeve bëhet për çdo njësi bazë, lidhur me kërkesat e shprehura prej tyre, duke marrë në konsideratë fondin e pagave, kontributet shoqërore dhe shëndetësore, për veprimtari shkencore dhe fondin e ekselencës. Gjatë hartimit të planit mbahen parasysh gjithashtu kërkesat për sigurimin e cilësisë, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse, shpenzimet për pasurimin e bibliotekës, bibliotekën <i>online</i>, etj.</p> <p>(<i>Evidenca shtesë 30</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Sipas <i>RVB, f. 47</i>, programi studimor dhe njësia kryesore e ajo bazë auditohen si pjesë e auditimit të brendshëm dhe jashtëm, nga ekspertë të licencuar për këtë qëllim, që UniBa kryen në baza vjetore. Këto auditime të përvitshme vlerësojnë dhe dokumentojnë gjendjen dhe performancën financiare të këtij institucioni. Raporti financiar i auditit përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare (<i>Evidenca shtesë 31; Evidenca shtesë 32</i>).</p> <p>UniBa, nëpërmjet Bordit të Administrimit, si organi kryesor ekzekutiv dhe administrativ, përpilon raport financiar për secilin vit akademik. Ky raport planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij (<i>Evidenca 1, neni 35</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për</p>	<p>Nga aktet e vënë në dispozicion rezulton që administratori i njësisë kryesore i raporton për veprimtarinë që lidhet me funksionim financiar administratorit të institucionit si dhe</p>




<p>programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>informon drejtuesin e njësisë kryesore për këtë veprimtari, ku përfshihen të dhëna lidhur me analizën e realizimit të buxhetit për një vit kalendarik, duke dhënë në mënyrë të detajuar realizimin e shpenzimeve sipas treguesve. Njëkëtë analizë përfshihet dhe rezultati i pritshëm i të ardhurave. Në vijim, administratori i institucionit i paraqet në përfundim të vitit akademik Bordit të Administrimit dhe senatit raportin mbi veprimtarinë financiare të institucionit.</p> <p><i>(Evidenca 1, nenet 39 dhe 40; Evidenca shtesë 30)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ, mbi bazën e të dhënave të vëna në dispozicion, vlerëson se institucioni paraqet qëndrueshmëri financiare dhe zotëron mjetet e nevojshme financiare në mbështetje të realizimit të programit Master i Shkencave në “Shkenca Juridike me profile: a) E drejtë penale dhe Kriminologji; b) E drejtë tregtare”.</p> <p>Por, duke pasur në vëmendje se burimin kryesor të të ardhurave faktike e përbëjnë tarifat e shkollimit, <i>sugjerohet që institucioni të planifikojë shtimin edhe të burimeve të tjera të financimit në të ardhurat institucionale (sikundër parashikohet në statut), për të siguruar vazhdimësinë e veprimtarisë së IAL përballë situatave të paparashikuara të riskut.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ për t’u shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Veprimtaria e institucionit i nënshtrohet një auditimi të përvitshëm, i cili kryhet nga ekspertë të licencuar. Përveç auditimit të jashtëm, realizohet dhe auditimi i brendshëm, në lidhje me destinacionin e përdorimit të të ardhurave.</i> - <i>Raportet e auditit përmbajnë në mënyrë të detajuar situatën financiare si dhe të dhëna për përdorimin e buxhetit të planifikuar për realizimin e programit mësimor. Të dhënat përfshijnë gjithashtu pagat, shpenzimet operative, detyrimet ndaj të tretëve, etj.</i> - <i>Drejtimit e shpenzimeve kanë të bëjnë me përmirësimin e mësimdhënies, hapësirat për studentët, përmirësimin e</i>




	<p><i>trajtimin të personelit akademik, të kushteve të punës së këtij personeli, shtimin e literaturës në bibliotekë, etj.</i></p> <p>- <i>Institucioni paraqet qëndrueshmëri financiare dhe zotëron mjetet e nevojshme financiare në mbështetje të realizimit të programit, objekt vlerësimi. Gjithsesi, për të ardhmen, GVJ sugjeron që institucioni të planifikojë shtimin edhe të burimeve të tjera të financimit në të ardhurat institucionale, ku pjesën dërrmuese e përbëjnë të ardhurat nga tarifatat e shkollimit (sikundër parashikohet në statut), për të siguruar vazhdimësinë e veprimtarisë së IAL përballë situatave të paparashikuara të riskut.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE


Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Universiteti “Barleti” ka të miratuara aktet e brendshme bazë për organizimin dhe mirëfunksionimin e programeve të studimeve, sipas cikleve përkatëse. Këto akte kanë të përcaktuara pranimin e studentëve dhe ecurinë e studimeve të tyre deri në fazën e diplomimit. Aktet e brendshme të institucionit janë të hartuara dhe miratuara në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në fushën e arsimit të lartë <i>(Evidenca 1; Evidenca 2; Evidenca shtesë 9)</i>





<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në rregulloren e përgjithshme të institucionit si dhe në rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare”, janë të përcaktuara kriteret e pranimit të studentëve. Aspektet procedurale të rekrutimit të studentëve janë të përcaktuara dhe në “Manualin e rekrutimit të studentëve”.</p> <p><i>(Evidenca 1; Evidenca shitesë 9; Evidenca 33)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Në fillim të çdo viti akademik, institucioni miraton dhe publikon dhe në faqen zyrtare, kriteret dhe procedurat e pranimit. Këto kriteret janë të bazuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e arsimit të lartë.</p> <p>Institucioni ka të miratuar dhe një dokument specifik, i cili lidhet me kriteret e rekrutimit, aplikimit regjistrimit dhe transferimit të studentëve <i>(Evidenca 33)</i>. Rregullorja e programit të studimit ka të përcaktuara kriteret e përgjithshme të pranimit të studentëve në këtë program studimit. <i>(Evidenca shitesë 9)</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Institucioni i bën transparente kriteret dhe procedurat e pranimit të studentëve në të gjitha programet e studimit, përfshirë dhe këtë program studimi.</p> <p>Në rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare”, janë të përcaktuara dhe kriteret e vlerësimit të dijeve përgjatë studimeve. Në çdo syllabus të lëndëve janë të përcaktuara kriteret e vlerësimit dhe komponentët përkatës. Këto bëhen të njohura për studentët në fillim të çdo semestri akademik. <i>(Evidenca “Syllabuset e lëndëve)</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Universiteti “Barleti” ka të miratuar “Manualin për rekrutimin, aplikimin, regjistrimin dhe transferimit të studentëve”. Ky dokument është publik dhe në faqen zyrtare të institucionit. Manuali ofron të gjithë informacionin e nevojshëm për kriteret dhe pranimin e studentëve në të gjitha programet e studimit. Në programin e studimit Master i Shkencave në “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare” janë të parashikuara dhe kriteret specifike të pranimit, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe sipas rregullores së këtij programi studimi. <i>(Evidenca shitesë 9; Evidenca 33)</i></p>





<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Në faqen zyrtare të institucionit publikohen dhe kriteret e vecanta për studentët që mund të përfitojnë bursa studimore, për shkak të statusit të tyre të vecantë. Institucioni aplikon dhe bursa të detikuara për kandidatët me aftësi të veçanta dhe për kategoritë e marginalizuara. (umb.edu.al/tarifa-dhe-bursa.htm)</p>			
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Institucioni miraton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret dhe procedurat për rekrutimin e studentët/kandidatët nga shtetet e tjera. Për vitin akademik 2022-2023 janë të miratuara 3 kuota për studentët nga trojet. Këto kuota janë të miratuara me vendimin e senatit (<i>Vendimi nr. 8, datë 11.03.2022</i>). Këto kuota janë të miratuara dhe nga MAS.</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Universiteti “Barleti” miraton për çdo vit akademik kriteret për akordimin dhe fitimin e bursave, sipas programeve përkatëse. Ky informacion është në faqen zyrtare të institucionit.</p> <p>Në rregulloren e institucionit janë të përcaktuara dhe kriteret për fitimin e bursave (<i>Evidenca 2</i>).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ, në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit:</i></p> <p><i>Universiteti “Barleti” ka të miratuar ‘Manualin për rekrutimin, aplikimin, regjistrimin dhe transferimit të studentëve’, i cili është publik dhe në faqen zyrtare të institucionit dhe ofron të gjithë informacionin e nevojshëm për kriteret dhe pranimin e studentëve në të gjitha programet e studimit .</i></p> <p><i>Në programin e studimit Master i Shkencave në “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare” janë të parashikuara dhe kriteret specifike të pranimin, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe sipas rregulloreve të këtij programi studimi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.2





Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare”, janë të përcaktuara rregullat mbi kriteret e vlerësimin të studentëve (<i>Evidenca shitesë 9</i>).</p> <p>Programet e lëndëve kanë të përcaktuara komponentët akademik të vlerësimin të studentëve. Studentët informohen nga strukturat përkatëse akademike dhe administrative për vlerësimet dhe për numrin e krediteve të përftuara.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në rregulloren e institucionit dhe të programit të studimit janë të përcaktuara rregullat mbi njohjen e lëndëve/krediteve të përftuara nga studimet e tyre në universitet brenda apo jashtë vendit. Miratimi i krediteve të përftuara bëhet nga strukturat përkatëse akademike. Në këtë program studimi nuk ka studentë të transferuar.</p> <p>(<i>Evidenca “Minutat e takimit të GVJ në sekretarine mësimore</i>) (<i>Evidenca 2; Evidenca shitesë 9</i>)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimin të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Regullorja e institucionit dhe e programit të studimit kanë të përcaktuara qartësisht kriteret dhe format e kontrollit dhe të vlerësimin të dijeve (<i>Evidenca 2; Evidenca shitesë 9</i>). Syllabuset e lëndëve kanë të përcaktuara komponentët e kontrollit të dijeve dhe vlerësimin të studentëve.</p> <p>(<i>Evidenca “Syllabuset e lëndëve”; Evidenca 11.1</i>)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit dhe në aktet e tjera bazë të institucionit (<i>Evidenca 1; Evidenca 2; Evidenca shitesë 9</i>), janë të përcaktuara kriteret e punimit të diplomës dhe diplomimit. Institucioni ka miratuar dhe dokumentin që lidhet me provën finale/punimin e diplomës. (<i>Evidenca 5; Evidenca shitesë 21</i>)</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë</p>	<p>Institucioni organizon në fillim të çdo viti akademik informimin për të gjithë ata që duan të studiojnë në një nga programet që ofrohen (<i>Evidenca shitesë 36</i>).</p>





publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Institucioni ka të miratuar një strategji të marketingut, në të cilën janë të përcaktuara politikat rekrutuese dhe informuese që aplikohen (<i>Evidenca shtesë 35</i>).			
Konkluzione	<i>GVJ, në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit:</i> <i>Institucioni ka të përcaktuar rregullat mbi kriteret e vlerësimit të studentëve. Studentët informohen nga strukturat përkatëse akademike dhe administrative për vlerësimet dhe për numrin e krediteve të përfutuara. Rregullorja e programit të studimit dhe aktet e tjera bazë të institucionit kanë të përcaktuara kriteret e punimit të diplomës dhe diplomimit. Institucioni ka miratuar dhe dokumentin që lidhet me provën finale/punimin e diplomës</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Institucioni informon studentët, përmes strukturave akademike dhe administrative, në lidhje me organizimin programit të studimit dhe objektivave bazë që lidhen në mënyrë specifike me këtë program studimi. Organizimi dhe struktura e programit të studimit Master i Shkencave në “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare”, është e përcaktuar dhe në rregulloren këtij programi. (<i>Evidenca shtesë 9</i>)
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet,	Institucioni ka të miratuara aktet e brendshme, në formën e rregulloreve, udhëzimeve dhe manualeve, të cilat përmbajnë informacionin e nevojshëm në lidhje me përmbajtjen e kurrikulës. Syllabuset e lëndëve përmbajnë dhe informacionin në lidhjet me veprimtarinë akademike dhe komponentët e






përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	vleresimit të dijeve. <i>(Evidenca shtesë 9; Evidencat mbi syllabuset)</i>			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Institucioni, përmes strukturave përkatëse informon studentët për mundësitë e punësimit dhe mbështetjes për kontaktet me tregun e punës. <i>(Evidenca shtesë 37; Evidenca shtesë 54.7; Evidenca shtesë 40)</i>			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Koordinatori i programit të studimit Master i Shkencave në “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare” , informon në vijimësi studentët, në lidhje me procesin mësimor dhe ofrimin e trajnimeve dhe shërbimeve të ofruara nga institucioni. Strukturat administrative të institucionit informojnë studentët për realizimin e procesit mësimor, duke ofruar mbështetjen e akademike dhe infrastrukturore. <i>(Evidenca shtesë 6; Evidenca shtesë 26)</i>			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Institucioni informon dhe mbështet studentët në realizimin e procesit mësimor. Institucioni ka hartuar udhëzues dhe manual për përdorime mjeteve teknologjike dhe përgjatë zhvillimit të procesit mësimor online/në distancë, duke ofruar informacionin e nevojshëm për studentët dhe stafin akademik. <i>(Evidenca 56; Evidenca shtesë 12; Evidenca shtesë 38; Evidenca shtesë 45&46)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ, në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit: Institucioni informon studentët, përmes strukturave akademike dhe administrative, në lidhje me organizimin e programit të studimit dhe objektivave bazë që lidhen në mënyrë specifike me këtë program studimi. Organizimi, struktura akademike, objektivat formuese, kurrikula e programit të studimit Master i Shkencave në “E drejta penale dhe kriminologji” dhe “E drejtë tregtare”, janë të përcaktuara në rregulloren e këtij programi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X





Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve										
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Univeristet “Barleti” disponon të dhëna mbi numrin e studentëve vlerësimin e tyre dhe numrin e të diplomuarve për këtë program studimi. Përmes sekretarisë mësimore dhe strukturave të tjera ndihmës-akademike dhe administrative si Zyra “Alumni & Karriera”, disponohen të dhëna mbi numrin e të diplomuarve për cdo program studimi, duke përfshirë dhe këtë program studimi.</p> <p><i>(Evidenca 34; Evidenca 39; Evidenca shitesë 39; Evidenca shitesë 54.5 & 54.6)</i></p>										
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Setretari mësimore disponon të dhëna mbi numri e studentëve të regjistruar në këtë program studimi; mbi vlerësimet e studentëve; mbi numrin e të diplomuarve etj. Sekretaria mësimore mban të dhënat mbi studentët në regjistrat përkatës, duke pasqyruar të dhënat mbi vlerësimet e tyre dhe mbi përfundimin e studimeve të tyre, deri në fazën e diplomimit. Në këtë program studimi nuk ka studentë të transferuar nga ndonjë universitet brenda apo jashtë vendit.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti gjatë takimit me sekretarinë mësimore, u vu re plotësimi i dokumentacionit ligjor në formë shkresore. U verifikua regjistri themeltar i studentëve për këtë program studimi si dhe regjistri i arritjeve akademike nga ku rezulton:</p> <table border="1" data-bbox="576 1444 1378 1845"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Programi/profil</th> <th>Nr i te regjistruarve</th> <th>Totali</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td rowspan="2">2020 - 2021</td> <td>E Drejtë penale dhe kriminologji</td> <td>17</td> <td rowspan="2">26</td> </tr> <tr> <td>E Drejtë Tregtare</td> <td>9</td> </tr> </tbody> </table>	Viti akademik	Programi/profil	Nr i te regjistruarve	Totali	2020 - 2021	E Drejtë penale dhe kriminologji	17	26	E Drejtë Tregtare	9
Viti akademik	Programi/profil	Nr i te regjistruarve	Totali								
2020 - 2021	E Drejtë penale dhe kriminologji	17	26								
	E Drejtë Tregtare	9									

	2021 - 2022	E Drejtë penale dhe kriminologji	14	19
		E Drejtë Tregtare	5	
	2022 - 2023	E Drejtë penale dhe kriminologji	10	17
		E Drejtë Tregtare	7	
	Totali			62
	<i>(Evidenca shitesë 'Minutat e takimit të GVJ në sekretarinë mësimore'); (Evidenca 34; Evidenca 55)</i>			
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	<p>Institucioni disponon elektronikisht dhe hard copy të të dhënave të studentëve, përmes sistemit të brendshëm të mbajtjes dhe aksesit të informacionit. Studentët informohen nga sekretaria mësimore dhe online, në lidhje me rezultatat e tyre.</p> <p>Portali studentor mundëson për studentët marrjen e informacionit të nevojshëm për rezultatet e vlerësimit dhe përmes komunikimit me stafin akademik, përgjegjës për këtë program studimi.</p>			
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me	<p>Institucioni ka krijuar strukturat e duhura administrative për të mbështetur procesin mësimor. Këto struktura koprojnë me njëra tjetrën, në funksion të procesit mësimor. Struktura administrative është e organizuara në bazë të statuti të institucionit dhe rregulloreve specifike për secilën prej tyre.</p> <p><i>(Evidenca 1; Evidenca 2)</i></p>			





veprimtarinë e tyre përkatëse.				
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Departamenti i Drejtësisë, si njësi bazë për këtë program studimi, harton raportin vjetor analitik mbi komponentët e procesit mësimor. Kjo njësi harton reaporte analitike periodike, të cilat mundësojnë një panoramë të punës së saj.</p> <p>Gjithsesi, ky raport vjetor nuk përmban një analizë specifike mbi ecurinë akademike të studentëve apo dhe mbi masat që mund të merren nga kjo njësi për përmirësimin e treguesve akademik të studentëve, për të mundësuar më pas një punësim të mundshëm në profilin përkatës që ofron ky program studimi.</p> <p><i>GVJ, rekomandon që kjo analizë vjetore e njësisë bazë të fokusohet dhe në të dhënat specifike të arritjeve të studentëve, në ato lëndë apo grup lëndësh, në të cilat studentët shfaqin rezultatet më të larta apo më të ulëta, për t'i motivuar apo për t'i orjentuar më mirë aftësitë e tyre akademike.</i></p> <p><i>(Evidenca shtesë 48)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ, në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit:</i></p> <p><i>Univeriteti "Barleti" disponon të dhëna mbi numrin e studentëve vlerësimet e dijeve të tyre dhe numrin e të diplomuarve për këtë program studimi, përmes sekretarisë mësimore dhe strukturave të tjera ndihmës-akademike dhe administrative. Të dhënat disponohen dhe përditësohen në bazë të akteve ligjore dhe nëligjore në fuqi si dhe më bazë të akteve të brendashme të miratuara nga institucioni.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.5


Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve






<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Universiteti “Barleti” ka të parashikuar në Statutin e institucionit përfshirjen e studentëve në organet vendimmarrëse. Studentët janë të përfaqësuar në senatin Akademik, Këshillin e Etikës, Komisionin e Sigurimit të Cilësisë dhe Standarteve.</p> <p>Departamenti i Drejtësisë/njësia bazë për këtë program studimi fton studentët që të jenë pjesë e mbledhjeve periodike të kësaj njësie. Studentët janë pjesë e grupeve të punës të krijuara nga njësia bazë dhe kryesore, si dhe në nivel institucional. Studentët kanë dhe organizmin e tyre brenda universitetit “Qeverinë Studentore”, një organizëm funksional brenda institucionit.</p> <p>Pyetësorët e studentëve janë një nga instrumentet e vlerësimit të cilësisë së procesit akademik.</p> <p><i>(Evidenca 11.2; Evidenca 31; Evidenca 30; Evidenca 37; Evidenca 38)</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Departamenti i Drejtësisë, si njësia bazë për këtë program studimi, realizon në vijimisi procesin e përmirësimit të syllabuseve të lëndëve, të cilat hartohen nga titullarët e lëndëve përkatëse dhe më pas miratohen nga drejtuesi i departamentit.</p> <p>Njësia e zhvillimit të kurrikulave dhe cilësisë, organizon për çdo semester akademik pyetësor tek studentët, përmes të cilëve merret dhe informacioni në lidhje me përmirësimete mundshme të kurrikulës.</p> <p><i>(Evidenca 10; Evidenca shtesë 31; Evidenca shtesë 32)</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/</p>	<p>Rregullorja e këtij programi studimi ka të përcaktuar procedurën dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve të studentëve. Syllabuset e lëndëve përmbajnë informacionin e nevojshëm, në lidhje me komponentët e vlerësimit të dijeve, të cilat u bëhen të njohura studentëve në fillim të çdo semestri akademik. Në rregulloren e programit të studimit është përcaktuar dhe mënyra e informit të studentëve më vlerësimin dhe procedura e ankimimit.</p> <p><i>(Evidenca shtesë 9)</i></p>





njesisë/pedagogut përgjegjës.									
Konkluzione	<p><i>GVJ, në lidhje me shkallën e përbushjes së standardit:</i></p> <p><i>Universiteti “Barleti” ka përfaqes të studentëve në organet vendimmarrëse të institucionit . Studentët janë të përfaqësuar në Senatin Akademik, Këshillin e Etikës, Komisionin e Sigurimit të Cilësisë dhe Standarteve.</i></p> <p><i>Departamenti i Drejtësisë/njësia bazë për këtë program studimi fton studentët që të jenë pjesë e mbledhjeve periodike të kësaj njësie. Studentët janë pjesë e grupeve të punës të krijuara nga njësia bazë dhe kryesore, si dhe në nivel institucional. Studentët kanë dhe organizmin e tyre brenda universitetit “Qeverinë Studentore”, një organizëm funksional brenda institucionit. Nëpërmjet pyetsorëve të studentëve, si një nga instrumentet e vlerësimit të cilësisë së procesit akademik, realizohen dhe procesi i përmirësimit të kurrikulës dhe syllabuseve të lëndëve.</i></p>								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin,</p>	<p>Institucioni ka krijuar struktura funksionale për informimin dhe rekrutimin e studentëve. Kontakti i parë me kandidatët, në ambjentet e institucionit është Zyra e Rekrutimit, Pranimit dhe Regjistrimit. Kjo zyrë/strukturë ndihmës-akademike vepron në bazë të rregullores së posacme të funksionimit të saj dhe të manualit përkatës (<i>Evidenca 33</i>).</p> <p>Pjesë e strukturës së institucionit është dhe Dekani i studentëve, i cili ndjek jo vetëm problematikave të studentëve kur ata janë pjesë e institucionit, por dhe procesin e rekrutimit dhe informimit të tyre, në lidhje me programet e studimit që ofrohen.</p>

<p>këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka miratuar dhe nje dokument që lidhet me politikat mbështetëse dhe përkrahëse për studentët (<i>Evidenca 37</i>).</p> <p>Koordinatori i këtij programi studimi është pjesë e strukturave informuese dhe koordinuese ndërmjet studentëve dhe stafit akademik, në lidhje me ecurinë e procesit mësimor. (<i>Evidenca shtesë 6</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> <p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Institucioni ngritur strukturat përkatëse për shërbimin e këshillimit të studentëve, në lidhje me karrierën dhe shërbimet e tjera që ofrohen gjatë periudhës së studimeve të tyre (<i>Evidenca 39</i>).</p> <p>Njësia bazë (Departamenti i Drejtësisë), organizon procesin e zhvillimit të praktikës profesionale, në bazë të rregullores së këtij programi studimi, duke bërë ndarjen përkatëse të stafit akademik që do të jetë përgjegjës për zhvillimin e këtij komponenti të kurrikulës së programit (<i>Evidenca shtesë 9; Evidenca shtesë 56</i>).</p> <p>Pjesë e strukturës së institucionit është dhe Dekani i studentëve, i cili në bashkëpunim dhe me strukturat përkatëse të institucionit (Zyra e Alumnit dhe Karrierës) bashkëpunon me njësinë bazë për të orjentuar dhe mbështetur studentët përgjatë procesit të këshillimit të tyre për në tregun e punës. Zyra e Alumnit dhe Karrierës, është një strukturë funksionale e institucionit, e cila vepron në bazë të rregullores përkatëse. Kjo zyrë mbështet studentët pas diplomimit, duke bashkërenduar punën e saj me njësinë bazë. Kjo zyrë harton dhe raporte periodike në lidhje me punësimin e studentëve dhe realizon dhe sondazhe me studentët e diplomuar (<i>sipas RVB-së, fq.61</i>)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ, në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit:</i></p> <p><i>Struktura akademike e institucionit mundëson mirëinformimin e kandidatëve për studentë që në momentin e parë të kontaktit të</i></p>





	<p>tyre me institucionin. Zyra e Rekrutimit,Pranimi dhe Regjistrimit është një zyrë/strukturë ndihmës-akademike që vepron në bazë të rregullores së posaçme të funksionimit të saj dhe të manualit përkatës për realizimin e këtij procesi.</p> <p>Pjesë e strukturës së institucionit është dhe Dekani i studentëve, i cili ndjek jo vetëm problematikat e studentëve kur ata janë pjesë e institucionit, por dhe procesin e rekrutimit dhe informimit të tyre, në lidhje me programet e studimit që ofrohen. Institucioni katë miratuar dhe nje dokument që lidhet me politikat mbështetëse dhe përkrahëse për studentët.</p> <p>Koordinatori i këtij programi studimi është pjesë e strukturave informuese dhe koordinuese ndërmjet studentëve dhe stafit akademik, në lidhje me ecurinë e procesit mësimor në funksion të mbështetjes së studentëve.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT


Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të	Struktura e programit dhe mësimdhënia bazohet në përdorimin e metodave të ndryshme dhe qasjen ndërdisiplinore. Përmirësimi i mësimdhënies nëpërmjet metodave të ndryshme dhe inovative, është një ndër qëllimet dhe objektivat kryesorë strategjike të UniBa (Evidenca 1, neni 7; Evidenca 3, pika 3).




<p>fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>UniBa ka dëshmuar aftësi për përshtatje të metodave dhe qasjes së mësimdhënies në rrethana të paparashikuara (siç është periudha e pandemisë së shkaktuar nga Covid-19). Gjithashtu, në nivel të programit të studimit, institucioni ka vënë në dispozicion edhe udhëzuesin për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. GVJ vëren se metodat e mësimdhënies janë në përputhje me përmbajtjen e lëndëve.</p> <p><i>(Evidenca 16; Evidenca 56; Evidenca “Aneks 1. Manuali i përdorimit të Google Classroom pedagogu”; Evidenca “Aneks 2. Manuali i përdorimit të Google Classroom për studentët”).</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Programi ka dy mekanizma kryesore për monitorimin dhe vlerësimin e aftësisë mësimdhënëse të personelit akademik: Komisioni i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë (i përmendur në vijim me inicialet KSSC) dhe Njësia e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë (e përmendur në vijim me inicialet NJZHKC) <i>(Evidenca 1, nenet 10, 28; Evidenca 10; Evidenca 31).</i></p> <p>Këto dy struktura mbështeten dhe nga Zv. Rektori për Çështjet Akademike dhe Zyra e vlerësimit të performancës <i>(RVB, f. 62).</i></p> <p>NJZHKC, si strukturë e ngritur me qëllim vlerësimin dhe kontrollin e cilësisë në vlerësimet periodike, përfshin edhe vlerësimin e pedagogut nëpërmjet anketimeve të studentëve mbi metodologjitë e mësimdhënies. Po ashtu, departamenti bashkëpunon dhe bashkërendon punën me strukturat institucionale për garantimin e cilësisë, duke përfshirë këtu edhe monitorimin periodik të performancës së personelit akademik dhe aftësive mësimdhënëse të tij. Rezultatet e monitorimeve përfshihen në raportin vjetor që bëhet në fund të çdo viti në departament si dhe në raportin vjetor të njësisë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë.</p> <p><i>(Evidenca 18; Evidenca shtesë 15; Evidenca shtesë 48; Evidenca shtesë “NjZhKC Raport 2022”)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve,</p>	<p>Institucioni ka parashikuar mekanizma të përshtatshëm që garantojnë përfshirjen e studentëve në vlerësimin e mësimdhënies. Në bazë të nenit 55/4, germa e) në lidhje me nenin 10/5 të statutit të UT-së, studentëve iu jepet mundësia për të vlerësuar format dhe metodat e mësimdhënies çdo vit, nëpërmjet pyetësorëve që realizohen në fund të zhvillimit të çdo semestri, duke ruajtur anonimat. Vlerësimi kryhet në formë</p>




<p>përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>klasike dhe elektronike. Pyetësorët përfshijnë pyetje mbi pedagogun, metodën e mësimdhënies, nivelin e përgatitjes, literaturën, përmbajtjen e lëndës, etj., si dhe për asistencën nga stafi administrativ. Gjetjet, pasi përpunohen, analizohen me qëllim përmirësimin e cilësisë (<i>Evidenca 1; Evidenca 10; Evidenca 23; Evidenca "Formular i vlerësimit të studentëve"</i>).</p> <p>Studentët kanë mundësi të parashtrojnë ankesa për rezultatet e provimeve (<i>Evidenca 2, nenet 89 dhe 90</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Programi ka mekanizma dhe struktura për përpunimin e rezultateve të vlerësimit të cilësisë në mësimdhënie, ua paraqet ato në formë të përgjithshme organeve përkatëse brenda institucionit si dhe u komunikon vlerësimet individuale personelit akademik dhe studentëve. Vlerësimet e cilësisë së mësimdhënies mund të bëhen publike në raportet periodike të njësisë kryesore (<i>Evidenca 10, neni 10</i>).</p> <p>Rezultatet e vlerësimit bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit: RVB-MSh-Shkenca-Juridike-2016.pdf (umb.edu.al).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Pavarësisht se nuk u prezantua ndonjë model i vlerësuar si shembull i një praktike të mirë, sipas shpjegimeve të marra gjatë vizitës, rezultatet e nxjerra përpunohen nga NJZHKC si dhe KSSC, duke vlerësuar nevojën për të zhvilluar më tej aspekte të veçantë të performancës në institucion. Mbi bazën e këtyre gjetjeve, KSSC harton planin e trajnimeve tematike në lidhje me metodat e mësimdhënies apo në funksion të përmirësimin të cilësisë (<i>Evidenca 1, neni 28; Evidenca 22; Evidenca shtesë 48; Evidenca shtesë "Minutat e takimit"</i>).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ për t'u shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Në funksion të zhvillimit dhe përdorimit të metodave të larmishme e inovative të mësimdhënies, institucioni ka hartuar dhe vënë në dispozicion udhëzues apo manuale të ndryshme informuese, në përputhje me objektivat institucionale.</i> - <i>Institucioni ka ngritur strukturat e duhura, përmes së cilave realizon kontrollin e performancës së stafit akademik si dhe cilësinë e mësimdhënies.</i>






	<p>- Në procesin e vlerësimit të mësimdhënies, sipas parashikimeve statutove dhe të akteve të tjerë të brendshëm, institucioni ka mundur të përfshirjen e studentëve, të cilëve iu jepet mundësia për të vlerësuar format dhe metodat e mësimdhënies çdo vit, nëpërmjet pyetësorëve që realizohen në fund të zhvillimit të çdo semestri.</p> <p>- Pas përpunimit statistikor dhe cilësor të të dhënave, këto të fundit iu komunikohen strukturave kompetente brenda IAL, të interesuarve si dhe bëhen publike. Rezultatet e marrëshfrytëzohen për vlerësimin e performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik dhe për nxitjen e përvojave pozitive.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2



Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Në përputhje me rregullimet ligjore të nenit 103 e vijues të ligjit Nr. 80/2015, të ndryshuar, UniBa ka bërë parashikime në aktet e brendshme rregullatore lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë, përkatësisht në nenet 10 e 28 të statutit, nenet 14-15 të Rregullores së përgjithshme, dhe në Rregulloren e fakultetit dhe të departamentit, duke përcaktuar detyrat e dekanit dhe përgjegjësit të departamentit në drejtim të proceseve të vlerësimit (<i>Evidenca 1; Evidenca 2; Evidenca "Rregullore e fakultetit", neni 6; Evidenca "Rregullore e departamentit", neni 5</i>).</p> <p>Në përputhje me këto parashikime, institucioni ka hartuar politikat përkatëse si dhe strukturat e nevojshme, që merren me monitorimin dhe përmirësimin në vijimësi të cilësisë, në nivel institucional dhe të çdo njësie (<i>Evidenca 10; Evidenca 31; Evidenca shtesë 15</i>). Detyrat e njësive lidhen me garantimin e plotësimin të standarteve të cilësisë në procesin akademik nga</p>


	ana e strukturave dhe organeve të institucionit. Institucioni ka hartuar dhe dokumentin “Rregullore për vlerësimin dhe administrimin e performancës” (<i>Evidenca 22</i>).
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	<p>Sipas parashikimeve statutores, rezultojnë se UniBa ka të ngritur dhe funksional sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë. KSSC, i cili është krijuar dhe miratuar nga Senati Akademik dhe vepron në nivel institucioni, është struktura përgjegjëse për garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit. Ky komision është i përbërë nga 5 anëtarë, njëri prej të cilëve është përfaqësues i studentëve (<i>Evidenca 31, neni 4</i>).</p> <p>Gjithashtu, në strukturat e UniBa përfshihet NJZHKC, e cila vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore. Kjo njësi përbëhet nga drejtuesi i saj si dhe 3 koordinatorë. Nuk është parashikuar që të ketë një përfaqësues nga studentët (<i>Evidenca 1, neni 28</i>).</p> <p>Sa i përket strategjisë, rëndësia që i ka dhënë IAL nuk shprehet vetëm në mënyrë të përgjithshme në strategjinë institucionale (<i>Evidenca 3</i>), por politika të detajuara janë shprehur në rregulloren e NJZHKC (<i>Evidenca 10</i>).</p> <p>Në procesin e vlerësimit dhe të sigurimit të cilësisë janë përfshirë dhe studentët (garantuar nga parashikimi përkatës në statutin e IAL, neni 55/4, germa e), të cilët japin kontributin e tyre gjatë realizimit të pyetësorëve dhe procesit të akreditimit institucional dhe të programeve (<i>Evidenca 10, neni 2, germa h; Evidenca 11.1</i>).</p> <p>Nga shqyrtimi i akteve të brendshme rregullatore konstatohet se në këtë proces nuk është parashikuar bashkëpunimi me ekspertë të jashtëm. Po ashtu, për hartimin e RVB nuk është parashikuar dhe mungon angazhimi i një përfaqësuesi të jashtëm (<i>Evidenca shtesë 7; Evidenca “Urdhër Rektori Nr. 25_1, datë 19.01.2023 Shkenca juridike; Evidenca shtesë 41</i>).</p> <p><u>GVJ sugjeron përfshirjen e një studenti në përbërje të NJZHKC, si dhe bashkëpunimin me ekspertë të jashtëm gjatë proceseve të vlerësimit të cilësisë.</u></p>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe	Institucioni përdor instrumente e metoda të ndryshme për vlerësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe

<p>treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>vlerësimit të brendshëm të institucionit, të cilat janë detajuar në aktet që parashikojnë instrumentet për kryerjen e këtyre vlerësimeve (<i>Evidenca 10, neni 9; Evidenca shitesë 15</i>).</p> <p>Të dhënat që merr institucioni nga studentët lidhen me aspekte të mësimdhënies, të programeve dhe të lëndëve mësimore. Metodatat që përdoren janë pyetësorët, intervistat, fokus grupet, etj. (<i>Evidenca 10, neni 2, germa h; Evidenca shitesë 15</i>).</p> <p>Vlerësimi që kryhet nga stafi akademik lidhet me aspekte të programeve, lëndëve dhe mësimdhënies. Metodatat që përdoren janë: pyetësorë, formularë vlerësimi, vetëvlerësimi, etj. (<i>Evidenca 10, neni 9; Evidenca 11</i>).</p> <p>Në përputhje me rregulloren e NJZHKC, UniBa e realizon sigurimin e cilësisë nëpërmjet procesit të sigurimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë. Në këtë dokument, institucioni ka qartësuar parime dhe standarde konkrete në shërbim të krijimit të një sistemi efikas për sigurimin e cilësisë (<i>Evidenca 10</i>).</p> <p>Në mënyrë periodike, institucioni realizon vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm institucional dhe atë të programeve të studimit, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Cilësisë në arsimin e lartë, standardet evropiane dhe ndërkombëtare, në vijim të të cilëve merr masat e duhura për plotësimin e rekomandimeve (<i>Evidenca 10; Evidenca shitesë "NJZHKC Raport 2020"</i>).</p> <p>Gjithashtu, institucioni ka zhvilluar një sërë veprimtarish në funksion të aftësisë të stafit për procesin e sigurimit të cilësisë (<i>Evidenca shitesë 54.4; Evidenca shitesë 54.7; Evidenca shitesë 54.1-54.3</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të</p>	<p>NJZHKC kishte një agjendë dhe plan pune të mirëpërcaktuar, ku përfshiheshin realizimi i pyetësorëve të studentëve, përpunimi i tyre dhe përcjellja e informacioneve deri në nivel rektorati (<i>Evidenca 32</i>). Rezultatet e marra nga monitorimi, analizat dhe raportet vihen në dispozicion të strukturave drejtuese të njësisë bazë, të cilat janë përgjegjëse për marrjen e masave përkatëse (<i>Evidenca 1, neni 5, germa c; Evidenca 18</i>).</p> <p>Gjithashtu, edhe nga takimi me përfaqësuesin e njësisë dhe studentët u konfirmua që kishin realizuar pyetësorët, sipas parashikimeve të bëra në aktet e brendshme rregullatore (<i>Evidenca shitesë "Minutat e takimit"</i>).</p>

mira në programin e studimit.									
Konkluzione	<p><i>GVJ për t'u shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkimore.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Në përputhje me parashikimet ligjore në fushën e arsimit të lartë, institucioni ka hartuar politikat përkatëse si dhe strukturat e nevojshme, që merren me monitorimin dhe përmirësimin në vijimësi të cilësisë, në nivel institucional dhe të secilës njësi kryesore. Detyrat e njërive lidhen me garantimin e plotësimit të standarteve të cilësisë në procesin akademik nga ana e strukturave dhe organeve të institucionit.</i> - <i>GVJ sugjeron përfshirjen e një studenti në përbërje të NJZHKC, si dhe bashkëpunimin me ekspertë të jashtëm gjatë proceseve për vlerësimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë.</i> - <i>Institucioni ka hartuar dokumentet përkatës që mundësojnë sigurimin e brendshëm të cilësisë.</i> - <i>Për vlerësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe vlerësimin të brendshëm përdoren instrumente e metoda të ndryshme.</i> - <i>Vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm i strukturave dhe programeve të studimit kryhet periodikisht sipas parashikimeve të Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë.</i> 								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Në përmbushje</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njërive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara	Në nivel institucional struktura përgjegjëse për monitorimin e cilësisë është KSSC, në bashkëpunim me NJZHKC. Në nivel njësie bazë është departamenti, i cili ofron programin e studimit së bashku me strukturat e tij të brendshme, të cilët rishikojnë dhe




për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.

Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.



vlerësojnë cilësinë e programit të studimit. Në nivel të njësisë bazë, të gjitha veprimtaritë e departamentit përfshihen në raportin vjetor të njësisë (*Evidenca 10; Evidenca "Rregullore e departamentit"; Evidenca "Raport i veprimtarisë së departamentit"*). Konstatohet se, programet e studimit, i nënshtrohen në mënyrë periodike monitorimit dhe vlerësimit nga sistemi i sigurimit të cilësisë, gjë që ndikon në përmirësimin e tyre (*Evidenca shtesë "Minutat e takimit"*).

Drejtimit e vlerësimit janë të ndarë sipas zërave përkatës në rregulloren e NJZHKC dhe përfshijnë vlerësimet e studentëve, vlerësimet e personelit akademik, formën individuale të vlerësimit të performancës së pedagogëve, formën e transparencës së notave, vlerësimin në raportet vjetore mbi procesin e të mësuarit dhe standardet përkatëse të cilësisë së departamentit në fund të vitit akademik. Kur është e nevojshme, rekomandohen masa për ndryshimin, rishikimin ose përmirësimin e elementeve të këtij programi. Për çdo ndryshim që ndërmerret propozimi dhe argumentimi bëhet nga departamenti dhe më pas përcillet në rektorat (*Evidenca 10; Evidenca 28; Evidenca "Propozim për riorganizimin e programit"*).


Në aktet rregullatore të sigurimit të cilësisë UniBa ka përcaktuar metodat dhe instrumentet e vlerësimit të cilësisë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe nga takimet e realizuara, GVJ konstaton se në tërësi këto mjete përdoren nga NJZHKC, me qëllim përgatitjen e raportit vjetor institucional, ku përfshihen informacione dhe vlerësime për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në institucion, cilësinë e shërbimeve të ofruar studentëve si dhe masat e rekomanduara në drejtim të përmirësimit të cilësisë. Mekanizmat më të përdorur janë pyetësorët e studentëve, vetëvlerësimi nga ana e pedagogëve, etj. (*Evidenca 10; Evidenca shtesë "Instrumentet e vlerësimit"; Evidenca 24; Evidenca shtesë "NJZHKC Raport 2022"*).

Në përfundim të procesit të vlerësimit, realizohet përpunimi i pyetësorëve. Në bazë të rezultateve të marra hartohet raporti, i cili iu përcillet autoriteteve drejtuese (*Evidenca 32*). Në raport mund të lihen rekomandime, të cilat do të shërbejnë për përmirësimin e programit të studimit. Rekomandimet mund të lihen për përmirësimin e kurrikulës së programit, ku në këtë rast

	<p>bëhen propozimet përkatëse nga departamenti dhe i përcillen për miratim Senatit Akademik (<i>Evidenca shtesë 11</i>).</p> <p>NJZHKC harton raportin vjetor të të dhënave të mbledhura nga procesi i monitorimit dhe vlerësimit dhe ua njofton stafit si dhe studentëve në sistemin e brendshëm të universitetit, por dhe publikisht në faqen elektronike zyrtare të tij (<i>Evidenca 10, neni 10; Evidenca shtesë "NJZKC Raport 2022"</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Një nga detyrat e NJZHKC është hartimi i raportit vjetor të vlerësimit. Ai duhet të përmbajë të dhëna nga raporti i vitit paraardhës dhe rezultatet që rrjedhin nga ai. Raporti përmbledh të dhëna të marra nga aktorë të ndryshëm, duhet të përqendrohet në përvojën e studentëve si dhe mënyrën e adresimit të çështjeve gjatë vitit akademik (<i>Evidenca shtesë NJZHKC Raport 2022</i>).</p> <p>Në nivel departamenti, në raportin vjetor të departamentit, bëhet një përshkrim i rezultateve të vlerësimeve, por nuk është hartuar një plan veprimi për masat e marra për adresimin e mangësive për vitin pasardhës akademik (<i>Evidenca "Raport i veprimtarisë së departamentit"; Evidenca shtesë 48</i>).</p> <p>Përfundimet e nxjerrë nga raporti vjetor institucional shërbejnë për marrjen e vendimeve për miratimin e planveprimeve në kuadër të përmirësimit dhe zhvillimit të programeve të studimit (<i>Evidenca 10; Evidenca shtesë 11</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime</p>	<p>Institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta për sigurimin e cilësisë si vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, kurrikulës, syllabuseve, rezultatet e të nxënësve, testet, etj.</p> <p>Gjithashtu, UniBa shqyrton vlerësimet që bëhen në përmblyllje të praktikës mësimore, nëpërmjet formularëve që plotësohen për këtë qëllim (<i>Evidenca shtesë "Instrumentet e vlerësimit"</i>).</p> <p>I gjithë informacioni i mbledhur përpunohet dhe analizohet në nivel njësie bazë dhe institucional (<i>Evidenca shtesë 58</i>).</p>





<p>ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Institucioni përdor metoda të tërthorta për sigurimin e cilësisë si, vlerësimet e drejtuesve, vlerësimet e ekspertëve, vlerësimet e studentëve, vlerësimet e të diplomuarve, vlerësimet e bashkëpunëtorëve, vlerësimet e punëdhënësve, të dhënat e mbledhura nëpërmjet anketimeve, intervistave, fokus-grupeve, vëzhgimeve, rezultateve të provimeve, të diplomimit (<i>Evidenca 10; Evidenca 11; Evidenca 11.1; Evidenca 11.2; Evidenca 18; Evidenca 24; Evidenca shitesë 15</i>).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ për t'u shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkimore.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Institucioni ka parashikuar në aktet e tij të brendshëm për sigurimin e cilësisë, shfrytëzimin e metodologjive të vlerësimit, instrumenteve të matjes dhe vlerësimit për programet e studimit.</i> - <i>Instrumentet dhe metodat e drejtpërdrejta e të tërthorta paraqiten në Rregulloren e NJZHKC, të miratuar nga senati akademik. Mekanizmat e përdorur janë pyetësorë dhe vlerësime të studentëve, fokus grupe me studentët, procesi i vlerësimit të anëtarëve të personelit akademik, procesi i vetëvlerësimit të pedagogëve, raporte vjetore të UniBa, etj.</i> - <i>Në tërësi këto mjete përdoren nga KSSC dhe NJZHKC, për të përgatitur raportin vjetor institucional, ku përfshihen të</i>





	<p><i>dhëna dhe vlerësime për mësimdhënien, kërkimin shkencor në institucion, cilësinë e shërbimeve të ofruar studentëve si dhe masat e rekomanduara në drejtim të përmirësimit të cilësisë. Raporti i paraqitet senatit akademik. Përfundimet e nxjerrë nga raporti vjetor institucional shërbejnë për marrjen e vendimeve për miratimin e planveprimeve në kuadër të përmirësimit, ndryshimit dhe zhvillimit të programeve të studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni, në aktet e tij të brendshëm dhe në politikat e procedurat e brendshme të cilësisë, ka parashikuar dhe figurat që përfshihen në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë (<i>Evidenca 1, nenet 10 e 28; Evidenca 10; Evidenca 31</i>).</p> <p>Në këtë proces janë përfshirë njësitë bazë, stafi akademik, por dhe studentët, të cilët japin kontributin e tyre gjatë realizimit të pyetësorëve dhe procesit të akreditimit institucional dhe të programeve (<i>Evidenca RVB</i>). Sikundër është theksuar më lart, nuk ka një përfaqësues të studentëve në përbërje të NJZHKC si dhe në statut dhe në rregulloren e përgjithshme, nuk ka parashikime të veçanta për bashkëpunimin me ekspertë të jashtëm.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton</p>	<p>UniBa ka përcaktuar detyrat që duhet të përmbushen nga personat e angazhuar në sistemin e brendshëm të cilësisë në nivel institucional dhe atë njësisë bazë. Detyrat dhe përgjegjësitë janë përmendur në nenet 10 e 28 të statutit, nenet 14-15 të rregullores së përgjithshme si dhe në rregulloret e NJZHKC dhe të KSSC.</p> <p>Gjithsesi, GVJ vëren se ka ende hapësirë për detajimin e përgjegjësive dhe detyrave në aktet e brendshme të UniBa. Konkretisht, sipas nenit 9 të Rregullore së NJZHKC, kjo e fundit</p>




<p>ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>ka hartuar një sërë procedurash për përmbushjen e funksioneve të saj, të cilat gjenden të detajuara në Manualin e Procedurave të Njësisë, dokument i cili nuk rezulton të jetë miratuar (<i>Evidenca 10</i>). <u>GVJ sugjeron hartimin e Manualit të Procedurave të Njësisë, në përputhje me parashikimet e Rregullores së NJZHKC</u>, pasi detajimi i hapave përkatës do të sqarojë më mirë detyrat e secilit në kuadër të sigurimit të cilësisë.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Sipas përcaktimeve të rregullores së NJZHKC, vlerësimi kryhet në çdo aspekt të veprimtarisë institucionale, mësimore, kërkimore e administrative (<i>Evidenca 10, neni 2</i>). Në këtë kuptim, vlerësimi mbështetet në shumëllojshmëri burimesh. Në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë, kjo rregullore përfshin të gjithë stafin e institucionit si dhe studentët, nëpërmjet përpilimit të pyetësorëve, formularëve përkatës, etj (<i>Evidencat 11; 11.1; 11.2 dhe 18; Evidenca 24</i>).</p> <p>Rregullorja e departamentit përcakton se përgjegjësi i departamentit bashkëpunon me NJZHKC dhe dekanin për realizimin me sukses të proceseve të vlerësimit dhe akreditimit të programeve që mbulon departamenti (<i>Evidenca "Rregullore e departamentit", neni 5</i>).</p> <p>Në procesin e vlerësimit të brendshëm, për efekte të akreditimit të programit, janë përfshirë anëtarë të stafit akademik, administrativ si dhe një student, të cilët ndjekin një metodologji të tillë që nënkupton përfshirjen e të gjithë këtyre aktorëve në proces(<i>Evidenca shitesë 7; Evidenca shitesë 41</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Vlerësimi i brendshëm i cilësisë konceptohet dhe zbatohet mbështetur në standardet profesionale, duke zbatuar parimin e pavarësisë institucionale (<i>Evidenca 1, neni 3; Evidenca 4</i>).</p> <p>Struktura, roli dhe përgjegjësitë e sistemit dhe organeve të sigurimit të cilësisë bazohen në kornizën ligjore të zbatueshme dhe në organizimin e brendshëm të institucionit. Duke mbajtur parasysh dhe qëllimet e vlerësimit si dhe mënyrat e marrjes dhe administrimit të të dhënave, procesi në tërësi e respekton integritetin akademik dhe nuk synon të krijojë diskriminim apo pabarazi kundrejt personelit dhe studentëve (<i>Evidenca 10</i>).</p> <p>Ky fakt rezultoi dhe gjatë takimeve me grupin e pedagogëve dhe të studentëve në institucion (<i>Evidenca shitesë "Minutat e takimit"</i>).</p>

<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Në statut dhe në rregulloren e përgjithshme të UniBa nuk ka parashikime të veçanta për bashkëpunimin me ekspertë të jashtëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë.Në RVB, f. 69, është vënë në dukje se pjesëe këtyre proceseve janë bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm, pedagogë me kohë të pjesshme, përfaqësues të institucioneve partnere, alumni, duke vënë në dispozicion dhe një dokument ilustrues lidhur me krijimin e bordit të karrierës dhe sugjerime për përmirësimin e programit mësimor të fakultetit të Drejtësisë, ku janë pjesëmarrës dhe disa alumni (<i>Evidenca shitesë 1</i>).</p> <p>Në këtë kuadër, <u>GVJ sugjeron që, në aktet e brendshme rregullatore të bëhen ndryshime duke parashikuar bashkëpunimin me ekspertë të jashtëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë si dhe nëhartimin e raportit të vlerësimit, të angazhohet dhe një përfaqësues i jashtëm.</u></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ për t'u shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë janë përfshirë njësitë bazë, stafi akademik, si dhe studentët, të cilët japin kontributin e tyre gjatë realizimit të pyetësorëve dhe procesit të akreditimit institucional dhe të programeve.</i> - <i>Në këtë proces nuk është parashikuar dhe bashkëpunimi me ekspertë të jashtëm.</i> - <i>Procesi në tërësi e respekton integritetin akademik dhe nuk synon të krijojë diskriminim apo pabarazi kundrejt personelit dhe studentëve.</i> - <u>GVJ sugjeron që, në aktet e brendshme rregullatore të bëhen ndryshime duke parashikuar bashkëpunimin me ekspertë të jashtëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë.</u> - <u>GVJ sugjeron që, në hartimin e raportit të vlerësimit, të angazhohet dhe një përfaqësues i jashtëm.</u> 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	





Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Organizimi dhe veprimtaritë që lidhen me sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë janë përfshirë në aktet e brendshme të UniBa. Ato janë transparente dhe mundësojnë akses jo vetëm nga studentët, por dhe nga çdo palë e interesuar. Sipas rregullores së NJZHKC, raportet vjetore të vlerësimit dhe raportet e vlerësimit të brendshëm për akreditimin e programeve të studimit dhe institucional, bëhen publike (<i>Evidenca 10, neni 10</i>).</p> <p>Raportet në fjalë gjenden në faqen elektronike të institucionit: https://umb.edu.al/dossier-uniba.html.</p> <p>UniBa dhe njësitë kryesore kanë përgjegjësinë për komunikimin dhe për publikimin e rezultateve të monitorimit, të vlerësimit dhe të akreditimit, ku një rol të rëndësishëm luan NJZHKC (<i>Evidenca 32</i>).</p>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	<p>Publikimi i rezultateve të vlerësimit të programit të studimit bëhet në përputhje me ligjin e aplikueshëm, Kodin e Etikës të UniBa dhe me aktet rregullatore të brendshme. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së të dhënave të përshkruara në raportet e publikuar në faqen zyrtare të UniBa si dhe pyetësorët e ndryshëm, nuk rezulton që të jetë cenuar liria dhe etika akademike apo të jenë cenuar të dhënat personale (<i>Evidenca 4; Evidenca 10; Evidenca shtesë 15; Evidenca "Raport i vlerësimit të studentëve"</i>).</p>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	<p>UniBa i përdor të dhënat e përfthuara nga metodat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta në funksion të rritjes së cilësisë së programit të studimit. Këto të dhëna përdoren gjithashtu edhe për hartimin e planit të masave që duhen marrë në nivel universiteti dhe njësie kryesore. Procedurat e sigurimit të cilësisë vlerësohen periodikisht dhe të gjitha rezultatet e performancës me propozimet përkatëse i paraqiten KSSC dhe Senatit. Vlerësimet programore e të departamenteve planifikohen për çdo vit akademik bazuar në rezultatet e proceseve të kryer (<i>Evidenca 10; Evidenca shtesë 52</i>).</p>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron	<p>Në tërësi, por edhe për sa përcaktuar nga neni 2 i rregullores së NJZHKC, nëpërmjet procesit vlerësues synohet përmirësimi i</p>

<p>efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>cilësisë së programeve të studimit dhe krijimi i kulturës së cilësisë në institucion. UniBa, në aktet e brendshme parashikon procedura të hollësishme lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit, hapat përkatëse dhe njësitë e strukturat që do marrin vendime në bazë të të dhënave të administruara nga procesi i vlerësimit të cilësisë. Si rezultat i këtyre proceseve janë ndërmarrë hapa konkrete për të ndryshuar programin e studimit (<i>Evidenca 10; Evidenca 28; Evidenca shtesë 11; Evidenca "Propozim për riorganizimin e programit"</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ vëren se institucioni ka organizuar veprimtari relativisht periodike me personelin dhe me studentët me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. Specifikisht, sipas të dhënave të marra gjatë vizitës dhe dokumentacionit të sjellë nga institucioni, rezultojnë të jenë zhvilluar disa aktivitete trajnuese për qëllime të akreditimit me personelin e punësuar në UniBa dhe studentët, me pjesëmarrjen e ekspertëve të fushës për informimin e tyre në lidhje me procesin e vlerësimit dhe akreditimit të programeve të studimit (<i>Evidenca shtesë 54.1; Evidenca shtesë 54.3; Evidenca shtesë 54.4; Evidenca shtesë 54.5; Evidenca shtesë 54.6; Evidenca shtesë 54.7</i>).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ për t'u shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkimore.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Politikat, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë që lidhen me sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë janë përfshirë në aktet e brendshme rregullatore të UniBa, janë transparente dhe mundësojnë parimisht akses jo vetëm nga studentët, por dhe nga çdo i interesuar.</i> - <i>Publikimi i rezultateve të vlerësimit të programit të studimit bëhet në përputhje me ligjin e aplikueshëm dhe me aktet rregullatore të brendshme të universitetit. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së të dhënave të përshkruara në raportet e publikuar në faqen zyrtare të institucionit si dhe pyetësorët e ndryshëm, nuk rezulton që të jetë cenuar liria dhe etika akademike apo të jenë cenuar të dhënat personale.</i> - <i>Institucioni ka parashikuar procedurat e nevojshme lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit, hapat përkatëse dhe njësitë e strukturat që do marrin vendime</i>




	<p>në bazë të të dhënave të administruara nga procesi i vlerësimit të cilësisë.</p> <p>- Institucioni ka organizuar veprimtari me personelin dhe me studentët, me qëllim që të jenë të informuar dhe të ndërgjegjësuar për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së këtij programi studimi dhe të institucionit në tërësi.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në: “Shkenca Juridike me profile: a) E drejtë penale dhe Kriminologji; b) E drejtë tregtare”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Institucioni ka krijuar përvojën e duhur sa i përket ngritjes dhe zhvillimit të programeve të ciklit të dytë të studimeve, sikundër është programi në vlerësim, përvojë e cila është thelbësore për të identifikuar dhe trajtuar problematikat dhe vështirësitë e mundshme që mund të hasen gjatë procesit;
2. Institucioni mbështet programin objekt vlerësimi dhe përgjithësisht veprimtaritë akademike, shkencore dhe administrative në një strukturë të organizuar dhe funksionale;
3. Personeli akademik i angazhuar në këtë program, ka përgjithësisht përvojë të gjatë në institucionet e arsimit të lartë apo në sektorin e drejtësisë, përdor metoda të frutshme të mësimdhënies, gjë e cila duhet vlerësuar si një element i rëndësishëm në drejtim të arritjes së objektivave në lidhje me cilësinë e programit të ofruar;
4. Institucioni zotëron ambiente me standardet e nevojshme për zhvillimin e programit të studimit, të pajisur me mjetet e përshtatshme nga ana logjistike;
5. Biblioteka garanton aksesin e duhur në literaturën që i shërben programit dhe fushës së drejtësisë në përgjithësi, si fizikisht ashtu edhe online;

b. Pika të dobëta:




1. Institucioni dhe njësia përgjegjëse që ofron këtë program studimi, nuk kanë në përdorim një platformë antiplagjiaturë; (*Standardi III.3, kriteri 5*)
2. Institucioni nuk ka arritur të përmbushë kriterin ligjor të mbulimit të ngarkesës nga staf akademik efektiv për vitin 2021-2022; (*Standardi IV.1, kriteri 2*)
3. Mungesa e marrëveshjeve me institucione të tillë si Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Spitale Psikiatrike si dhe institucione të tjerë, ku mund të realizohen praktika në lidhje me probleme të caktuara e specifike krimnologjike, në funksion të përmbushjes së objektivave të këtij programi studimi; (*Standardi IV. 2, kriteri 5*)


Rekomandime

1. Institucioni duhet të hartojë një plan pune dhe një buxhet shoqërues për hapat që do të ndërmerren për plotësimin e organikës së departamentit me staf me kohë të plotë sipas specifikimeve ligjore;
2. Institucioni si dhe njësia bazë duhet të marrin masa me qëllim rishikimin e syllabuse-ve për të përfshirë në ta më shumë detaje mbi kriteret e vlerësimit të secilit component si dhe të më tepër udhëzimeve mbi aktivitetet e punës në grup dhe kriteret e vlerësimit të pjesëmarrjes aktive;
3. Institucioni duhet të marrë masa konkrete për ngritjen e një sistemi të efektshëm antiplagjiaturë;
4. Institucioni duhet të lidhë marrëveshje me institucione të tillë si Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Spitale Psikiatrike si dhe institucione të tjerë, ku mund të realizohen praktika në lidhje me çështje specifike krimnologjike, në funksion të përmbushjes së objektivave të programit të studimit;
5. Institucioni duhet të planifikojë shtimin edhe të burimeve të tjera të financimit në të ardhurat institucionale për të siguruar vazhdimësinë e veprimtarisë së tij përballë situatave të paparashikuara të riskut;
6. Institucioni duhet të rishikojë, me qëllim përmirësimi, aktet e brendshme në funksion të sigurimit të cilësisë dhe plotësimin e standardeve të vendosur në këtë drejtim;
7. Në aktet e brendshme rregullatore për sigurimin e cilësisë të parashikohet përfshirja e një studenti në përbërje të NJZHKC si dhe bashkëpunimi me ekspertë të jashtëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë;

Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle Master of Science in: "Legal Science with profiles: a) Criminal law and Criminology; b) Commercial law"

a. Strengths and affirmations:

1. The institution has created the appropriate experience in terms of setting up and developing the programs of the second cycle of studies, as is the program under evaluation, experience which is essential to identify and deal with the possible problems and difficulties that may be encountered during the process;





2. The institution supports the program under evaluation and generally its academic, scientific and administrative activities in an organized and functional structure;
3. The academic personnel engaged in this program generally have long experience in higher education institutions or in the justice sector, use fruitful teaching methods, which should be evaluated as an important element in terms of achieving the objectives regarding the quality of the program offered;
4. The institution owns facilities with the necessary standards for the development of the study program, equipped with the appropriate logistical tools;
5. The library ensures adequate access to literature that serves the program and the field of law in general, both physically and online;

b. Weaknesses:

1. The institution and the responsible unit offering this study program do not use an anti-plagiarism platform; (*Standard III.3, criterion 5*)
2. The institution has not managed to fulfill the legal criterion of covering the workload by effective academic staff for the year 2021-2022; (*Standard IV.1, criterion 2*)
3. The lack of agreements with institutions such as the General Directorate of Prisons, Psychiatric Hospitals as well as other institutions, where practices can be carried out in relation to certain specific criminological problems, in order to fulfill the objectives of this study program; (*Standard IV 2, criterion 5*)

Recommendations

1. The institution must draw up a work plan and an accompanying budget for the steps to be taken to complement the department's organics with full-time staff according to legal specifications;
2. The institution as well as the basic unit should take measures in order to revise the syllabuses to include in them more details on the evaluation criteria of each component as well as more instructions on group work activities and evaluation criteria of active participation;
3. The institution must take concrete measures for the establishment of an effective anti-plagiarism system;
4. The institution must enter into agreements with institutions such as the General Directorate of Prisons, Psychiatric Hospitals and other institutions, where internships can be carried out in relation to specific criminological issues, in order to fulfill the objectives of the study program;
5. The institution should plan the addition of other sources of financing to the institutional income to ensure the continuity of its activity in the face of unforeseen risk situations;
6. The institution must review, with the aim of improvement, the internal acts in function of quality assurance and the fulfillment of the established standards in this regard;
7. In the internal regulatory acts for quality assurance, the inclusion of a student in the composition of NJZHKC, as well as cooperation with external experts in the evaluation and internal quality assurance processes, should be foreseen;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

